



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN
3 korrik 2005**

Raporti i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it



Varshavë

7 nëntor 2005

Përmbajtja

I.	PËRMBLEDHJE
II.	HYRJE DHE FALENDERIME
III.	SFONDI POLITIK
IV.	KUADRI LIGJOR
	A. LEGJISLACIONI NË FUQI
	B. SISTEMI ZGJEDHOR
	C. VLERËSIMI I KUADRIT LIGJOR
V.	ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE
	A. STRUKTURA DHE PËRBËRJA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE
	B. VLERËSIMI I ORGANIZIMIT TË ZGJEDHJEVE
VI.	REGJISTRIMI I PARTIVE DHE KANDIDATËVE
	A. REGJISTRIMI I LISTAVE SHUMEMËRORE KOMBËTARE
	B. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE NË ZONAT NJËMËRORE
VII.	REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE
	A. KUADRI RREGULLUES
	B. VLERËSIMI I PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË ZGJEDHËSVE
VIII.	FUSHATA ZGJEDHORE
IX.	MEDIA.....
	A. KUADRI RREGULLUES
	B. MONITORIMI I MEDIAS
X.	ANKIMET DHE APELIMET PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE
XI.	PJESËMARRJA E PAKICAVE
XII.	PJESËMARRJA E GRAVE
XIII.	SHOQËRIA CIVILE DHE VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE
XIV.	VËZHGIMI I VOTIMIT DHE NUMËRIMIT
	A. PROCESI I VOTIMIT.....
	B. NUMËRIMI I VOTAVE
XV.	ANKIMET DHE APELIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE
XVI.	ZGJEDHJET E PËRSËRITURA (21 GUSHT 2005).....
XVII.	REKOMANDIME
XVIII.	SHTOJCË 1: REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE

XIX. SHTOJCË 2: PROCESI ANKIMOR NË ZONËN 73

XX. SHTOJCË 3: INFORMACION MBI OSBE/ODIHR-IN

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN
3 korrik 2005**

MISIONI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE I OSBE-ODIHR-IT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR¹

I. PËRMBLEDHJE

Në përgjigje të një ftese nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin, të datës 3 korrik 2005, më 18 maj të vitit 2005, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) ngriti një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ). Misioni vlerësoi procesin zgjedhor, përsa i përket përpurthshmërisë me Angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it bashkoi përpjekjet me vëzhgues nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së (AP e OSBE-së), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) dhe Parlamenti European (PE) për ngritjen e një Misioni Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ) për të vëzhguar procedurat e ditës së zgjedhjeve.

Zgjedhjet për Kuvendin të datës 3 korrik 2005 u përputhën, vetëm pjesërisht, me angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe shënuan disa përparime në zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Gara kishte konkurrencë dhe zgjedhësve iu ofrua një mundësi e gjerë zgjedhjeje midis një sërë partish politike. Megjithatë, procesi ishte sërish i tejzgatur dhe, ndonjëherë, i pasigurt.

Partitë e mëdha zhvilluan fushata të bujshme. Media elektronike ishte përgjithësisht e ekuilibruar në pasqyrimin e subjekteve zgjedhore dhe bëri përpjekje për përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore. Sidoqoftë, ajo iu dha dy partive më të mëdha më shumë kohë sesa u takonte në bazë të ligjit dhe nuk ishte njëtrajtshme në pasqyrimin e partive të vogla. Pavarësisht nga një fushatë përgjithësisht e qetë, pati disa incidente, përfshirë një incident vdekjeprurës me armë zjarri në ditën e zgjedhjeve.

Këto zgjedhje ishin të parat që u zhvilluan sipas një Kodi të ri Zgjedhor, miratuar në vitin 2003 dhe ndryshuar në vijim. Megjithëse ka hapësira për përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor, ligji, përgjithësisht, mundëson zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Sidoqoftë, duhet ende që partitë e mëdha politike të shfaqin vullnet politik dhe përgjegjësi në të njëjtën masë me autoritetin e gjerë që u është dhënë për procesin zgjedhor. Kjo ishte veçanërisht e dukshme në qëndrimin e partive ndaj administratës zgjedhore, respektimin e plotë të të drejtave themelore të shtetasve dhe zbatimin e strategjive për rritjen në maksimum të fitimeve zgjedhore. Këto strategji dëmtuan objektivin kushtetues për proporcionalitet "në raport sa më të afërt" të sistemit zgjedhor, që mbetet i hapur ndaj abuzimit dhe duhet të reformohet në mënyrë përfshirëse.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) e administroi procesin në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe përforcoi reputacionin e tij si një organ kolegjal efektiv, transparent dhe

¹ Ky raport është i përkthyer në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

mjaft i paanshëm. Një pjesë e madhe e 100 Komisioneve të Zonave Zgjedhore (KZZ), Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) dhe Grupeve të Numërimit (GN) u ngritën me vonesë, gjë për të cilën partitë mbajnë pjesën e tyre të përgjegjësisë. Vëzhguesit raportuan se, shpesh, anëtarët e KZZ-ve dhe KQV-ve dukej se u jepnin përparësi interesave partiake, në vend që të respektonin plotësisht ligjin.

Një përpjekje e konsiderueshme dhe relativisht e suksesshme, edhe pse e vonuar, e autoriteteve shtetërore dhe atyre vendore solli një kuadër të ri për regjistrimin e zgjedhësve, që përcaktonte një ndarje të qartë të përgjegjësisë të organeve të përfshira. Në shumë zona zgjedhore, ky proces rezultoi në përmirësimin e saktësisë së listave të zgjedhësve. Megjithatë, vlera e këtyre përpjekjeve u zbeh nga mosveprimi për një kohë të gjatë i autoriteteve shqiptare në krijimin e një sistemi të njëtrajtshëm të adresave të ndërtesave dhe dokumenteve të reja personale të identifikimit. Si rrjedhim, listat e zgjedhësve mbetën një çështje e debatueshme. Megjithatë, me disa përjashtime, vëzhguesit nuk vërejtën përpjekje të qëllimshme për heqjen e së drejtës së votës zgjedhësve ose, nga ana tjetër, për manipulimin e listave të zgjedhësve për përfitime politike.

Zhvillimi i procesit të votimit shfaqti vetëm përparim të kufizuar. Në shumë raste, KQV-të nuk respektonin mjaftueshëm procedurat e duhura, veçanërisht për sa i përket përdorimit të bojës për parandalimin e votimit të shumëfishtë, fshehtësisë së votës dhe kontrollit të identitetit të zgjedhësve. Numri i zgjedhësve që u kthyen mbrapsht nga qendrat e votimit, pasi emrat e tyre nuk gjendeshin në listat e zgjedhësve, ishte më i vogël.

Numërimi i votave pati shpesh debate dhe mbyllja e procesit zgjati shumë më tepër nga sa ishte parashikuar në ligj. Ndërsa disa prej vonesave erdhën për shkak të lodhjes, pjesa më e madhe e tyre u shkaktuan nga pengimi i procesit. Gjatë ecurisë së numërimit, vëzhguesit raportuan një numër parregullsish serioze në disa zona, përfshirë raste kur votat nuk u numëruan në mënyrë të ndershme.

Edhe pse u deshën gjashtë javë që KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor të shqyrtonin të gjitha ankimet paszgjedhore, kryesisht për shkak të depozitimit të çështjeve të pabazuara nga partitë, ankimet u trajtuan në mënyrë të drejtë. Sidoqoftë, në disa raste, ankimuesve iu mohua zgjidhja efektive ligjore, për shkak të vendosjes së theksit më shumë në formën e ankimit sesa në përmbajtjen e tij, si edhe për shkak të mungesës së vullnetit nga ana e KQZ-së për shfrytëzimin e plote të kompetencave të veta hetimore mbi këto raste.

Popullsia e pakicave, sidomos ajo Rome, vazhdoi të mënjanohej dhe ishte subjekt i kërcënimeve gjatë zgjedhjeve dhe përpjekjeve për "blerjen e votave". Me qëllim përmirësimin e regjistrimit së tyre si zgjedhës dhe pjesëmarrës në zgjedhje, duhen bërë përpjekje të mëtejshme.

Zgjedhjet sollën vetëm një rritje të të vogël të numrit të ulët të grave deputete. Gjithashtu, gratë janë, në mënyrë të konsiderueshme, të nënpërfaqësuar në administratën zgjedhore. Kërkohen përpjekje të mirëfillta për trajtimin e pabarazisë gjinore në çështjet publike në Shqipëri.

OSBE/ODIHR-i, ashtu si edhe institucionet e tjera të përfaqësuar në MNVZ, mbetet i angazhuar për të mbështetur përpjekjet e autoriteteve shqiptare me qëllim zhvillimin e

zgjedhjeve në Shqipëri në përputhje me Angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera për zgjedhje demokratike.

II. HYRJE DHE FALENDERIME

Në përputhje me angazhimet e Shqipërisë si Shtet anëtar i OSBE-së, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) mori një ftesë për vëzhgimin e procesit zgjedhor të 3 korrikut 2005. Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) u ngrit zyrtarisht më 18 maj, i drejtuar nga Z. Jorgen Grunnet (Danimarkë). MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it përbëhej prej 40 ekspertësh në fushën e zgjedhjeve dhe vëzhgues afatgjatë (VA), me qendër në Tiranë dhe 11 qytete të tjera.

Ambasadori Andreas Nothelle (Gjermani) bashkërendoi Delegacionin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së. Z. Jerzy Smorągowski (Poloni), anëtar i Senatit të Polonisë, drejtoi Delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE). Znj. Doris Pack (Gjermani), anëtare e Parlamentit Evropian, drejtoi Delegacionin e PE-së. MNVZ-ja dërgoi 408 vëzhgues nga 36 Shtete anëtare të OSBE-së, përfshirë 23 parlamentarë nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së, 20 nga APKE-ja dhe nëntë nga PE-ja. MNVZ-ja vëzhgoi procesin e votimit dhe numërimit të votave në mbi 1 200 QV në të gjithë vendin dhe në 97 vende të numërimit të votave (VNV).

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i shpreh mirënjohjen Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe autoriteteve të tjera shtetërore e vendore për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. MVZ-ja i është gjithashtu mirënjohëse Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për mbështetjen gjatë gjithë kohëzgjatjes së misionit, si edhe ambasadave të Shteteve anëtare të OSBE-së të akredituara në Tiranë. MVZ-ja i është gjithashtu mirënjohëse Misioneve të OSBE-së në Kosovë dhe Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për mbështetjen e dhënë me dërgimin e vëzhguesve.

III. SFONDI POLITIK

Zgjedhjet për Kuvendin të datës 3 korrik 2005 ishin të gjashtat që prej vendosjes së sistemit shumëpartiak në vitin 1991, në Shqipëri. Që atëherë, dy partitë më të mëdha, Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD) kanë mbizotëruar skenën politike. Shpesh, rivaliteti mes tyre ka qenë i ashpër, bazuar në mungesën reciproke të besimit dhe, herë pas here, antagonist. Gjatë viteve të fundit kjo ka shkaktuar ndërprerje politike, shpesh të zgjidhura përmes ndërmjetësimit të institucioneve ndërkombëtare, veçanërisht të OSBE-së.

Zgjedhjet e fundit për Kuvendin u mbajtën në vitin 2001 dhe ato për organet e qeverisjes vendore në vitin 2003. Të dyja proceset ishin të tejzgjatura dhe të diskutueshme, me zgjedhje të përsëritura në një numër zonash për shkak të parregullsive. Në vitin 2001, PS-ja, e udhëhequr nga z. Fatos Nano, fitoi shumicën e vendeve (73). Ajo krijoi një qeveri koalicioni dhe pati mbështetje parlamentare prej 13 deputetëve të zgjedhur nga katër parti të tjera² dhe dy deputetëve të zgjedhur si kandidatë "të pavarur". PD-ja, e udhëhequr nga z. Sali Berisha,

² Partia Socialdemokrate (PSD), Partia Agrare Ambientaliste (PAA), Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) dhe Aleanca Demokratike (AD).

dhe parti të tjera të opozitës, fituan 52 vende³. PD-ja i konsideroi zgjedhjet e vitit 2001 të karakterizuara nga mashtrimi dhe bojkotoi institucionet kryesore, përfshirë Kuvendin. Në shkurt të vitit 2002 filloi një fazë me më pak përplasje, e cila çoi në hapjen e diskutimeve mbi një reformë të kuadrit zgjedhor dhe zgjedhjen me konsensus të z. Alfred Moisiu si President i Republikës së Shqipërisë nga Kuvendi, në verën e vitit 2002. Një muaj pas zgjedhjes së presidentit, kryetari i PS-së, Fatos Nano, u bë Kryeministër.

Në vjeshtën e vitit 2004, ish-Kryeministri i PS-së, Ilir Meta, u shkëput nga grupi parlamentar socialist dhe themeloi Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI). Në atë kohë, LSI-ja përfaqësohej në Kuvend me 9 deputetë të cilët, në vitin 2001, ishin zgjedhur si kandidatë të PS-së. Që nga viti 2004, PLL-ja hyri në aleancë me Partinë Demokratike të Rinovuar për të krijuar Lëvizjen pro-monarkiste për Zhvillim Kombëtar – Leka Zogu I (LZHK).

IV. KUADRI LIGJOR

A. LEGJISLACIONI NË FUQI

Zgjedhjet u zhvilluan sipas një Kodi të ri Zgjedhor, i miratuar në qershor të vitit 2003⁴. Në vitin 2004, OSBE/ODIHR-i dhe Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës nxorën "Rekomandimet e Përbashkëta" për përmirësimin e kuadrit legjislativ, me qëllim përmbushjen e angazhimeve të OSBE-së dhe standardeve të tjera ndërkombëtare.

Si rrjedhim, Kodi Zgjedhor u ndryshua në tetor 2004, janar 2005 dhe prill 2005. Amendamentet, disa prej të cilave pasqyruan Rekomandimet e Përbashkëta, sollën një sërë ndryshimesh, veçanërisht në lidhje me administratën e zgjedhjeve, hartimin e listave të zgjedhësve, kriteret për ndarjen e zonave zgjedhore, procesin e numërimit dhe trajtimin e ankimeve dhe apeli meve. Këto ndryshime u hartuan në pjesën më të madhe gjatë një procesi dypartiak ku përfshiheshin PS-ja dhe PD-ja.

Kufijtë e rinj të zonave zgjedhore u përcaktuan nëpërmjet një ligji të veçantë (Mars 2005), si rezultat i një marrëveshjeje politike dypartiake PS-PD. Ndonëse zonat aktuale zgjedhore shënojnë një përmirësim krahasuar me kufijtë e mëparshëm, në bazë të listave të zgjedhësve të përgatitura për këto zgjedhje, disa zona nuk i plotësojnë kërkesat ligjore⁵, veçanërisht, disa prej tyre devijuan së tepërmi nga "numri mesatar i zgjedhësve për një zonë zgjedhore"⁶.

³ Në zgjedhjet e vitit 2001, PD-ja kandidoi në koalicion me Partinë Republikane (PR), Partinë Bashkimi Liberal (PBL), Partinë Lëvizja e Legalitetit (PLL) dhe Partinë e Ballit Kombëtar (PBK). Në vitin 2001, Partia Demokratike e Re (PDR), gjithashtu në opozitë, kandidoi e vetme.

⁴ Legjislacioni përkatës për zhvillimin e zgjedhjeve përfshin edhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurave Administrative, ligje të ndryshme dhe udhëzimet e KQZ-së dhe ministrive.

⁵ Për shembull, zona 85 nuk ka vazhdueshmëri.

⁶ Ndonëse Neni 181, pika 1 e Kodit Zgjedhor përcakton se "Asnjë zonë zgjedhore nuk lejohet të ketë devijim më të madh se 10 për qind nga numri mesatar i zgjedhësve në shkallë Republike", numri i zgjedhësve në disa zona ndryshonte me më shumë sesa 10 për qind nga numri mesatar në shkallë Republike. Sipas Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias [CDL-AD (2002)23, faqe 7] "devijimi i lejueshëm nga norma nuk duhet të jetë më shumë sesa 10 %". Ekzistenca e zonave zgjedhore, përmasa e të cilave ndryshon së tepërmi nga mesatarja e vendit, është në kundërshtim me parimin e së drejtës së votës së barabartë. Sidoqoftë, përvijimi i kufijve të zonave u krye pjesërisht në bazë të shifrave të cilat, përveç numrit të votuesve të regjistruar në këto zona për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore në vitin 2003, pasqyrojnë edhe shifrat e pjesëmarrjes së zgjedhësve dhe të dhënat nga regjistrimi i popullsisë dhe banesave i vitit 2001.

B. SISTEMI ZGJEDHOR⁷

Neni 64 i Kushtetutës (1998) përcakton sistemin zgjedhor që vijon:

- Kuvendi përbëhet nga një numër i përcaktuar deputetësh (140). 100 deputetë (71%) zgjidhen drejtpërdrejt në zona zgjedhore njëemërore (këtej e tutje 'mandate njëemërore') me numër të përafërt zgjedhësish dhe 40 deputetë (29%) zgjidhen nga listat shumëemërore të partive ose koalicioneve të partive (këtej e tutje 'mandate plotësuese');
- "Numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie [...] përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin [...]" (Neni 64.2); dhe
- Partitë duhet të marrin të paktën 2,5 për qind të votave të vlefshme dhe koalicionet duhet të marrin të paktën 4 për qind të votave të vlefshme, për të përfituar nga ndarja e 40 mandateve plotësuese.

Sistemi ekzistues zgjedhor u parashikua për herë të parë nga Kodi i mëparshëm Zgjedhor (në vitin 2000), mbështetur në interpretimin e Nenit 64 të Kushtetutës. Kodi Zgjedhor i vitit 2003 e përpunoi më tej sistemin. Ndryshe nga Kodi Zgjedhor i vitit 2000, për zgjedhjen e kandidatëve në 100 zonat zgjedhore kërkohej një shumicë e thjeshtë dhe jo një shumicë absolute votash⁸. Neni 65 i Kodit Zgjedhor përcakton se 40 'mandatet plotësuese' shpërndahen "sipas përqindjes proporcionale të votave të fituara nga listat shumëemërore [të partive]". Sidoqoftë, ligji nuk parashikon një sistem zgjedhor "paralel", duke qenë se shpërndarja e 'mandateve plotësuese' është e lidhur pazgjidhshmërisht me numrin e mandateve njëemërore të fituara nga kandidatët e çdo partie apo koalicioni. Sipas Kodit (Neni 67), nëse numri i mandateve njëemërore të fituara nga çdo parti/koalicion është më i madh sesa numri i përgjithshëm i mandateve që u takon, nëse 140 mandatet do të shpërndaheshin nëpërmjet një sistemi të pastër proporcional (Neni 67.1.b), partia/koalicioni nuk do të përfitonte asnjë prej 40 mandateve plotësuese⁹. Ndërkohë që Neni 67 i Kodit Zgjedhor përpiqet të respektojë Nenin 64.2 të Kushtetutës, objektivi i proporcionalitetit në përbërjen e Kuvendit pengohet nga kombinimi i katër faktorëve:

1. Numri i mandateve plotësuese është i përcaktuar dhe jo i ndryshueshëm.
2. Numri i mandateve plotësuese është relativisht i vogël (40) dhe, si rrjedhim, mund të mos jetë i mjaftueshëm për arritjen e proporcionalitetit.

⁷ Rregullat për kthimin e votave në mandate.

⁸ Në vitin 2001, për zgjedhjen e 100 kandidatëve kërkohej 50% + 1 e votave. Në rast se asnjë prej kandidatëve nuk e siguronte shumicën e votave në raundin e parë, zhvillohej një raund i dytë (balotazh) mes dy kandidatëve me numrin më të madh të votave.

⁹ *Ndër të tjera*, Neni 67 përcakton se numri i votave të vlefshme të fituara nga çdo parti ose koalicion që arrin pragun përkatës, pjesëtohet me shumën e përgjithshme të votave të vlefshme të të gjitha partive që kalojnë pragun dhe rezultati shumëzohet me 140 (numri i përgjithshëm i deputetëve). Kjo përcakton një 'ndarje paraprake mandatesh'. Në këtë sistem, partitë që marrin një numër të konsiderueshëm të votave në zgjedhjet për listat shumëemërore të partive ("në shkallë vendi"), por asnjë apo pak mandate njëemërore, mund të presin të përfitojnë një numër mandatesh plotësuese për të bërë të mundur që përfaqësimi i tyre në Kuvend të jetë në raport sa më të afërt të mundshëm me përqindjen e votave që kanë marrë në zgjedhjet për listën shumëemërore të partisë. Në të kundërt, partitë ose koalicionet që marrin një pjesë të madhe të mandateve njëemërore, mund të marrin një numër të vogël ose asnjë mandat plotësues.

3. Pamundësia e “heqjes” së ndonjë prej mandateve njëemërore të fituara nga një kandidat partie; dhe
4. Dispozita që përcakton se zgjedhjet zhvillohen me dy fletë votimi¹⁰ (Kodi Zgjedhor, Neni 90).

Është me rëndësi se kuadri ligjor nuk siguron realizimin e objektivit të shprehur të Kushtetutës, me fjalë të tjera, krijimin e një kuvendi bazuar mbi parimin e përfaqësimit proporcional. Partitë politike mund të anashkalojnë synimin e sistemit zgjedhor dhe të shtrembërojnë shpërndarjen e mandateve plotësuese në favor të tyre, duke përdorur metoda të ndryshme. Për shembull, nëse mbështetësit e një partie (Partia A) i ndajnë rregullisht votat e tyre mes kandidatit që përfaqëson Partinë A dhe listës shumëemërore të një partie tjetër, zyrtarisht ose jozyrtarisht aleate (Partia B), atëherë numri i kombinuar i mandateve të fituara nga të dyja partitë ka të ngjarë të rritet. Edhe pse kjo strategji mund të mos bjerë në kundërshtim me ligjin, ajo mbetet problematike për një numër arsyesh:

- Mund të funksionojë vetëm duke ulur efektivitetin e Nenit 67 të Kodit Zgjedhor në përbushjen e qëllimit të tij dhe bie ndesh me objektivin e deklaruar të Kushtetutës.
- Dobëson në mënyrë domethënëse ‘lidhjen’ mes dy pjesëve të votimit, duke i shndërruar zgjedhjet *de facto* të ngjashme me ‘sistem zgjedhor paralel’.
- Sjell rrjedhimisht uljen e numrit të mandateve që u jepen partive, të cilat nuk përfshihen në një strategji të njëjtë apo të ngjashme.
- Zbeh dallimin midis partive politike dhe, si rrjedhim, mund të çorientojë zgjedhësit; dhe
- Nuk i lejon zgjedhësit të kuptojnë saktësisht se si kthehen votat e tyre në mandate.

Megjithëse strategji të ngjashme janë zbatuar në një shkallë më të vogël në vitin 2001¹¹, dispozitat e Kodit Zgjedhor mbi shpërndarjen e mandateve plotësuese mbetën të pandryshuara në pjesën më të madhe të tyre.

C. VLERËSIMI I KUADRIT LIGJOR¹²

Edhe pse Kodi Zgjedhor ka vend për përmirësime të mëtejshme, ai mund të shërbejë si bazë për zgjedhje demokratike, nëse zbatohet në mirëbesim nga autoritetet shtetërore dhe partitë politike. Sidoqoftë, edhe pse partitë politike luajnë një rol qendror në një proces demokratik zgjedhor, ndonjëherë, Kodi Zgjedhor vendos interesat e tyre mbi ato të shtetasve. Pavarësisht nga shumë aspekte positive të Kodit Zgjedhor, dy mangësitë vijuese bien në kundërshtim me standardet ndërkombëtare:

- Kodi Zgjedhor u lejon partive të depozitojnë në KQZ marrëveshje të brendshme partiake për rirenditjen e përfituesve të mandateve, sipas kriterëve të përcaktuara nga partitë¹³. Në

¹⁰ Çdo zgjedhës hedh dy vota, njëra për kandidatin që konkurren drejtpërdrejt në zonën njëemërore dhe një për kandidatin e listës shumëemërore të partisë ose koalicionit, pa asnjë kufizim në zgjedhjen e tij.

¹¹ Shih Raportin Përfundimtar të OSBE-ODIHR-it mbi zgjedhjet e vitit 2001.

¹² Kufizimet e hapsirës përjashtojnë një analizë të plotë e gjithëpërfshirëse të kuadrit ligjor. Mungesa e komentit për sa i përket një dispozite të caktuar nuk nënkupton se dispozita nuk mund të përmirësohet.

¹³ Siç vihet në dukje në vlerësimet e përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2004: “në atë shkallë që [ligji] do të lejonte ri-renditjen ose renditjen “përfundimtare” të kandidatëve pasi zgjedhësi të ketë votuar, atëherë [kjo] do të binte në kundërshtim me Angazhimet e OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare.

vitin 2005, shumë parti depozituan marrëveshje të tilla në KQZ¹⁴. Kjo është problematike, sepse ul sigurinë e zgjedhësve se vota e tyre do të kthehet në mandate të shpërndara sipas kritereve transparente.

- Kodi (Neni 163) u jep partive të drejtën për të ndikuar në përzgjedhjen e grupit të gjyqtarëve që do të shqyrtojnë ankimet zgjedhore¹⁵.

Ndërkohë që, sipas Nenit 154 të Kushtetutës, kompetenca për zgjedhjen e anëtarëve të KQZ-së është e drejtë kushtetuese e Kuvendit, Presidentit dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Neni 22 i Kodit Zgjedhor e kufizon domethënien e kësaj të drejte nëpërmjet dhënies së kompetencave propozuese partive politike. Megjithatë, Kushtetuta nuk e përjashton mundësinë e propozimit të anëtarëve prej partive politike. Në këtë aspekt, çështja qëndron në faktin se zgjedhja që partitë politike u kanë ofruar tre institucioneve emëruese është kufizuar në maksimumin e dy emrave për listë,¹⁶ në vend të pjesëmarrjes së partive në procesin e propozimit. Të njëjtën rëndësi ka edhe profili i kandidaturave të propozuara nga partitë. Në fakt, interesat e dy partive më të mëdha politike kontrollojnë funksionimin e KQZ-së nëpërmjet propozimit të anëtarëve.

Sipas Kodit Zgjedhor, gjashtë parti propozojnë të gjithë anëtarësinë e KZZ-ve dhe KQV-ve¹⁷. Këtyre partive u është dhënë e drejtë e pakufizuar për zëvendësimin e anëtarëve të KZZ-së dhe KQV-së *në çdo kohë për çdo arsye*. Ato mund të vonojnë dorëzimin e listës së personave të propozuar për grupet e numërimit deri në dy orë para mbylljes së votimeve. Argumentet në favor të këtyre privilegjeve ligjore paraqiten zakonisht si mënyrë për parandalimin e përpjekjeve të mundshme për 'blerjen' e anëtarëve të komisioneve zgjedhore. Sidoqoftë, këto privilegje bëjnë të mundur që partitë, veçanërisht dy më të mëdhatë, të ushtrojnë një nivel të lartë ndikimi në stabilitetin, profesionalizmin, pavarësinë dhe paanshmërinë e administratës zgjedhore dhe, rrjedhimisht, të krijojnë mundësi për një ndikim negativ në procesin e zgjedhjeve.

Kodi Zgjedhor favorizon disa parti, p.sh., ai përcakton se anëtarët e KQZ-së propozohen vetëm nga partitë e krahut politik 'të majtë' ose 'të djathtë'. Kjo diskriminon partitë që nuk janë të rreshtuara qartë në asnjërin prej krahëve politikë¹⁸. Përveç kësaj, partitë joparlamentare nuk kanë të drejtën të marrin kopje të tabelave zyrtare të rezultateve nga KZZ-të dhe partitë 'më të vogla' përballen me kufizime në përçimin e mesazheve të fushatës, p.sh., në fushën e reklamave politike me pagesë në mediat elektronike private, ku Kodi u jep partive 'më të mëdha' të drejtën për të blerë dyfishin e minutazhit të partive 'më të vogla'. Këta faktorë krijojnë 'rregulla loje' zgjedhore të pabarabarta dhe, për rrjedhojë, bien ndesh me aspektet e paragrafit 7.6 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së.

¹⁴ Marrëveshjet e brendshme partiake përmbanin shpesh formula që merrnin në konsideratë rezultatet zgjedhore të listës së partisë/koalicionit ose të kandidatëve të veçantë në zona të caktuara zgjedhore. Sidoqoftë, PS-ja dhe PD-ja dorëzuan lista zgjedhore me një renditje të përcaktuar të kandidatëve.

¹⁵ OSBE/ODIHR-i dhe Komisioni i Venecias kanë shprehur më parë shqetësimin e tyre të përbashkët në lidhje me Nenin 163. Shih Rekomandimin No. R (94) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve; Parimet Bazë të OKB-së mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor; Paragrafet 5.12 dhe 5.13 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së (1990) dhe Paragrafet 19.1 dhe 19.2 të Dokumentit të Moskës të OSBE-së (1991).

¹⁶ Shih Rekomandimet e Përbashkëta të OSBE-ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias mbi Kodin Zgjedhor dhe Administratën Zgjedhore në Shqipëri - [CDL-AD(2004)017rev2], faqe 8.

¹⁷ Gjashtë partitë që arrijnë rezultatin më të lartë zgjedhor në zgjedhjet e mëparshme për Kuvendin.

¹⁸ LSI-ja u ankua se ishte diskriminuar, pasi e kishte ligjërisht të pamundur që të zëvendësonte vëzhguesit e saj në zgjedhje pas afatit të 18 qershorit, ndërsa PS-ja dhe PD-ja mund t'i zëvendësonin anëtarët e organeve zgjedhore sipas dëshirës.

Pas nënshkrimit të një Protokolli PS-PD më 17 maj 2003 dhe disa ndryshimeve vijuese, Kodi përcakton se, në rast se votimi për listat shumëmemërore të partive shpallet pjesërisht i pavlefshëm, për shembull në një zonë zgjedhore, ai nuk duhet të përsëritet. Zgjedhësit e prekur do të kenë vetëm një votë (për garën për mandatin njëmemëror), ndërsa të tjerët do të kenë dy. Pavarësisht nga problemet me të cilat është përballur Shqipëria në zgjedhje të mëparshme, përsa i përket fragmentimit të procesit zgjedhor, duhet të vihet në dukje se mospërsëritja e zgjedhjeve për listën shumëmemërore të partive në një zonë të caktuar mund të çenojë barazinë e votës, një standard i vendosur ndërkombëtar dhe mund të ndikojë në shpërndarjen e mandateve.

Megjithëse paraqesin disa përmirësime në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, kur thuajse nuk ekzistonin, dispozitat mbi financimin e fushatës nuk kanë njëtrajtshmëri; p.sh., ndërsa Neni 144 përcakton se kufiri i shpenzimeve të fushatës për një parti politike përfshin edhe shpenzimet e kandidatëve të vet, Neni 145.1 nuk u kërkon kandidatëve të partive të raportojnë mbi shpenzimet e tyre, qoftë drejtpërdrejt apo nëpërmjet partisë. Kërkesa për deklarimin e shpenzimeve lidhet vetëm me ato që janë kryer brenda periudhës së kufizuar të fushatës. Si rrjedhim, dispozitat ligjore mund të anashkalohen nëpërmjet llogaritjes së kujdesshme të kohës kur bëhen dhurimet dhe shpenzimet. Në fund, partive nuk u kërkohet të paraqesin raporte financiare mbi shpenzimet në fushatë deri 45 ditë pas zgjedhjeve, duke ulur, kështu, transparencën.

Kodi i lejon partitë politike të ankimojnë tabelën e rezultateve të një KZZ-je dhe, veçmas, t'i kërkojnë KQZ-së shpalljen e pavlefshme të rezultateve të zonës zgjedhore. Kur në KQZ paraqiten sëbashku një ankesë dhe një kërkesë për pavlefshmëri, kjo e fundit merret në shqyrtim e para. Një gjë e tillë nuk është efikase dhe tabela e rezultateve të KZZ-së mund të përbëjë një provë të rëndësishme në mbështetje të kërkesës për pavlefshmërinë e rezultateve të zonës zgjedhore.

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

A. STRUKTURA DHE PËRBËRJA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

Zgjedhjet për Kuvendin në Shqipëri administrohen nga një administratë zgjedhore prej tri nivelesh: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), 100 Komisionet e Zonave Zgjedhore (KZZ) dhe 4 764 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV) u ngritën në vitin 2005. Përveç këtyre, në çdo zonë zgjedhore u ngritën deri në pesë Grupe Numërimi (GN) për numërimin e votave në 100 Vende të Numërimit të Votave (VNV).

KQZ-ja është një organ i përhershëm i përbërë prej shtatë anëtarësh¹⁹. Anëtarët e KQZ-së kanë një mandat shtatëvjeçar. Partitë politike ushtrojnë një ndikim të konsiderueshëm mbi përbërjen e KQZ-së, duke qenë se ato propozojnë kandidaturat për anëtarë. Sipas një marrëveshjeje të arritur në tetor të vitit 2004 mes PS-së dhe PD-së, 'balancimi politik' i KQZ-së u ndryshua, pasi PS-ja 'i dorëzoi' opozitës një prej pesë vendeve të saj²⁰.

¹⁹ Përveç kësaj, një Sekretar 'pa të drejtë vote' caktohet në KQZ, si edhe në 100 KZZ-të dhe KQV-të.

²⁰ Krahu politik i majtë dhe i djathtë propozojnë, nga tre anëtarë secili, një për secilin nga tre organet emëruese. Të dyja palët paraqesin së bashku propozime për një anëtar të tretë që caktohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Pas ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, më 10 janar të vitit 2005, në përputhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias²¹, pjesa më e madhe e vendimeve të KQZ-së merren me shumicë votash: duhen të paktën katër vota për marrjen e një vendimi dhe seancat e KQZ-së janë të vlefshme kur të paktën katër anëtarë janë të pranishëm në to. Sidoqoftë, duhet një shumicë e cilësuar prej të paktën pesë votash për certifikimin e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve dhe për gjykimin e ankimeve ndaj vendimeve të KZZ-së në lidhje me rezultatet e zgjedhjeve. Partitë politike kanë të drejtë të emërojnë përfaqësues në KQZ, të cilët mund të marrin pjesë në diskutime, por nuk kanë të drejtën e votës në lidhje me çështjet për të cilat merr vendime KQZ-ja²².

Çdo KZZ përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët u emëruan nga KQZ-ja në bazë të propozimeve të kombinuara nga tri partitë më të mëdha të krahut të majtë dhe tri partitë më të mëdha të krahut të djathtë²³. LSI-ja nuk kishte të drejtë të propozonte anëtarë për KZZ-të, KQV-të apo GN-të, pavarësisht se perceptohej si partia e dytë më e madhe e krahut të majtë²⁴. LSI-ja kritikoi atë çka ajo e quajti 'ndarje politike dy partiake' dhe u ankua se ishte e pamundur që ajo të ndikonte në vendimet e KQZ-së. PS-së dhe PD-së iu dha e drejta për propozimin e anëtarit të shtatë mbi baza barazie të përcaktuara nga "përzgjedhja rastësore" dhe "shpërndarja e barabartë". Kryetari i KZZ-së u emërua nga blloku politik që kishte shumicën në KZZ-në përkatëse, ndërsa zëvendëskryetari dhe sekretari u emëruan nga pakica. Kodi Zgjedhor parashikon që, nëse partitë nuk arrijnë të emërojnë anëtarët, e drejta e emërimit i kalon partisë tjetër më të madhe nga e njëjta anë e spektrit politik. Sidoqoftë, pavarësisht se disa parti nuk i bënë emërimet brenda afatit ligjor, KQZ-ja nuk e zbatoi këtë dispozitë.

KQV-të dhe GN-të kishin të njëjtën përbërje politike si KZZ-të. Partitë politike dhe kandidatët e pavarur kishin të drejtën për të patur vëzhgues në KZZ, KQV, si edhe VNV.

B. VLERËSIMI I ORGANIZIMIT TË ZGJEDHJEVE

Përgjithësisht, KQZ-ja e administroi procesin zgjedhor në përputhje me Kodin Zgjedhor. Gjatë periudhës zgjedhore, ajo zhvilloi mbledhje të shpeshta, mori mbi 1 700 vendime dhe miratoi rreth 20 udhëzime që rregullonin procesin. Në pjesën më të madhe, mbledhjet e KQZ-së u zhvilluan në mënyrë profesionale, kolegjiale dhe transparente. Propozimet e përfaqësuesve të partive u shqyrtuan në mënyrë të drejtë. Gjatë fazës parazgjedhore, vëzhguesit e MVZ-së së OSBE-ODIHR-it nuk vërejtën asnjë njëanshmëri politike pro apo kundër ndonjë aktori zgjedhor. Edhe pse, ndonjëherë, diskutimet ishin të tejzgjatura dhe vendime të rëndësishme u morën me vonesë, në përgjithësi, kjo nuk pati ndonjë efekt negativ domethënës mbi përgatitjet zgjedhore.

Gjithashtu, edhe administrata e KQZ-së i kreu detyrat e veta në mënyrë të paanshme dhe profesionale gjatë gjithë periudhës zgjedhore. Përveç administratës në Tiranë, KQZ-ja ngriti 12 Zyra Zgjedhore Rajonale që iu dhanë KZZ-ve mbështetje teknike e logjistike. Edhe pse jo të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, këto zyra luajtën një rol pozitiv gjatë zgjedhjeve duke e rritur fluksin e informacionit drejt KZZ-ve.

²¹ Shih Rekomandimet e Përbashkëta të OSBE-ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2004, faqe 9.

²² Përfaqësuesit e partive parlamentare kanë status të përhershëm. Ata të partive joparlamentare nuk kanë status të përhershëm.

²³ PS-ja, PSD-ja dhe PBDNJ-ja (të krahut të majtë) dhe PD-ja, PDR-ja dhe PR-ja (të krahut të djathtë).

²⁴ E drejta e propozimit bazohet në rezultatet e arritura në zgjedhjet e fundit për Kuvendin (2001).

Gjatë organizimit të zgjedhjeve, KQZ-ja u përball me një sërë sfidash logjistike dhe administrative. Sipas Kodit Zgjedhor, KZZ-të duhej të ishin ngritur deri më 3 mars të vitit 2005. Kjo rezultoi e pamundur, duke qenë se, në këtë kohë, nuk ishin miratuar ende kufijtë e zonave zgjedhore. KQZ-ja vendosi shtyrjen e mbledhjeve të para të KZZ-ve deri më 16 maj, me qëllim që t'u jepte kohë partive të propozonin anëtarët për KZZ-të. Megjithatë, vetëm 63 KZZ ishin ngritur deri në përfundim të afatit të ri, kryesisht pasi disa parti, vecanërisht PD-ja dhe PR-ja, nuk i dërguan propozimet e tyre në kohë. Pak pas përfundimit të procesit të ngritjes së KZZ-ve, disa parti ushtruan gjerësisht të drejtën e tyre për zëvendësimin e anëtarëve. Edhe pse numri i zëvendësimeve u ul me afrimin e ditës së zgjedhjeve, sjellja e disa partive shkaktoi paqendrueshmëri në KZZ dhe disa prej anëtarëve u emëruan pas përfundimit të trajnimeve. Më tej, disa prej autoriteteve të qeverisjes vendore nuk bashkëpunuan plotësisht me KQZ-në. Ato nuk i respektuan afatet ligjore për dorëzimin e numrave përfundimtarë të zgjedhësve të regjistruar dhe vendndodhjen e qendrave të votimit (QV), duke bërë të nevojshme vendosjen e gjobave nga KQZ-ja.

Të paktën gjysma e kryetarëve të KZZ-ve kishin qenë pjesë në një KZZ në zgjedhje të mëparshme. Kjo eksperiencë mund të ketë rezultuar e vlefshme në administrimin e zgjedhjeve. Sidoqoftë, një pakicë të konsiderueshme të KZZ-ve i mungonin burimet e duhura materiale dhe shumica njoftoi se nuk kishte marrë fondet operative në kohë. KZZ-të u përballën gjithashtu me sfida të mëdha në lidhje me emërimin e anëtarëve të KQV-ve, sërish për shkak të mosrespektimit të afateve të propozimit nga partitë. Disa parti politike i justifikuan veprimet e tyre duke pretenduar se, nëse anëtarët e KQV-ve dhe GN-ve bëheshin të njohur shumë kohë përpara zgjedhjeve, ata mund të korruptoheshin ose kërcënoheshin. Përsa u përket KZZ-ve, vonesat në emërimin e anëtarëve të KQV-ve nënkuptonin se shumë prej tyre nuk do të mund të merrnin pjesë në trajnimet e organizuara nga KQZ-ja. Vëzhguesit në rreth 10% të zonave vunë në dyshim pavarësinë e KZZ-ve dhe disa prej tyre dukej se merrnin vendime më shumë mbi bazën e kriterëve politike sesa atyre administrative.

VI. REGJISTRIMI I PARTIVE DHE KANDIDATËVE

Procedura e regjistrimit përfshin dy faza. Së pari, partitë politike duhet të regjistrohen si subjekte zgjedhore në KQZ. Më pas, ato duhet ose të paraqesin një listë shumemërore në shkallë vendi për 40 mandatet plotësuese, ose kandidatë që konkurrojnë në zona për mandate njëemërore, ose të dyja bashkë. Partitë duhet të regjistrohen veçmas si subjekte zgjedhore përpara se të hyjnë në një koalicion.

Në zgjedhjet e vitit 2005, KQZ-ja regjistroi fillimisht 57 parti si subjekte zgjedhore. Mes këtyre 57 partive të regjistruara si subjekte zgjedhore, 10 parti nuk paraqitën asnjë listë shumemërore për zgjedhjet në shkallë vendi, 19 parti do të kandidonin si pjesë e katër koalicioneve dhe 28 parti do të konkurronin veçmas në garën për listat kombëtare shumemërore.

A. REGJISTRIMI I LISTAVE KOMBËTARE SHUMEMËRORE

Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve duhet të regjistrohet në KQZ. Kodi Zgjedhor bën një dallim mes procedurës së regjistrimit të 'partive parlamentare' dhe 'partive joparlamentare'. Partitë joparlamentare duhet të paraqesin firmat e të paktën 7 000 zgjedhësve

të regjistruar, ndërsa koalicionet e partive joparlamentare duhet të paraqesin të paktën 10 000 firma. Kjo kërkesë është e arsyeshme dhe në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare të pranura²⁵. Partive të përfaqësuara në legjislaturën e fundit u kërkohet të depozitojnë një deklaratë të firmosur nga të paktën një deputet i kësaj legislature se ai është *anëtar* i partisë në fjalë. Koalicionet mund të paraqesin, gjithashtu, deklaratë nga deputetë të legjislaturës së fundit, të cilët janë anëtarë të një prej partive të koalicionit. Këto deklaratë duhet të jenë në numër të njëjtë me partitë e përfshira në koalicion. Është pozitiv fakti se, nëse KQZ-ja konstaton mangësi në dokumentacionin e regjistrimit, partitë nuk përjashtohen, por u lihet dy ditë për të zgjidhur këto mangësi.

Mes 28 partive që u regjistruan për të konkurruar të vetme, tetë përfaqësoheshin në legjislaturën e fundit dhe dy parti të tjera²⁶ u trajtuan si të tilla nga KQZ-ja. Meriton vëmendje trajtimi i këtyre dy rasteve të fundit. Dokumentacioni që Kuvendi i dërgoi KQZ-së në lidhje me çështje të tjera të ndryshme nuk i rendiste asnjërën prej tyre si parti me përfaqësim parlamentar. Listat e dy partive u dorëzuan pa asnjë firmë mbështetëse. Sidoqoftë, secila prej këtyre dy partive ishte në gjendje të depozitonte një deklaratë nga një deputet i legjislaturës së fundit se ai ishte *anëtar* i asaj partie, ndërkohë që asnjëri prej tyre nuk ishte zgjedhur nën siglën e partisë për të cilën depozitoi deklaratën dhe të dy konkurronin për llogari të partive të tjera në zgjedhjet e vitit 2005. Megjithatë, KQZ-ja i pranoi deklaratat si të mirëqena dhe i regjistroi të dyja partitë pa kërkuar firma mbështetëse.

Tetëmbëdhjetë partitë e tjera që konkurronin të vetme duhej të paraqisnin listat me firmat mbështetëse. KQZ-ja skualifikoi 11 prej tyre për parregullsi në listën e firmave. Kolegji Zgjedhor rrëzoi vendimin e skualifikimit të KQZ-së vetëm për një parti. Në fund, nga 28 parti që bënë përpjekje për të regjistruar listat shumemërore në shkallë vendi për 40 mandatet plotësuese, vetëm 18 prej tyre mundën të kandidonin.

Listat e depozituara nga koalicionet duhej t'u nënshtroheshin këtyre dy procedurave. Nga 57 parti të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, 19 paraqitën katër marrëveshje të veçanta për koalicione:

- Shtatë parti, të konsideruara afër me PD-në, paraqitën një listë për krijimin e koalicionit 'Aleanca për Liri, Drejtësi dhe Mirëqenie' (ALDM);²⁷
- Tri parti (PLL-ja, Partia Demokratike e Rinovuar dhe Partia Konservatore) krijuan koalicionin e quajtur Lëvizja për Zhvillim Kombëtar – Leka Zogu I (LZHK);
- Katër parti të papërfaqësuara në legjislaturën e fundit krijuan një koalicion të quajtur Partitë Sociale Shqiptare dhe Partia për Bashkim Kombëtar (PSSH + PUK);
- Pesë parti krijuan koalicionin Lëvizja Demokratike për Integrim (LDI).

Gjashtë prej shtatë partive që përbënin koalicionin ALDM dhe dy nga tri partitë që përbënin koalicionin LZHK, përfaqësoheshin në Kuvend. Në të dyja rastet, ato kishin një numër të mjaftueshëm të deputetëve në legjislaturën e fundit për t'u përjashtuar nga detyrimi për paraqitjen e firmave mbështetëse²⁸.

²⁵ Shih Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias [CDL-AD (2002) 23], faqe 6

²⁶ Partia Balli Kombëtar dhe Partia e Sigurisë Kombëtare.

²⁷ Partia Demokratike e Re (PDR), Partia Demokratike (PDK), Bashkimi Liberal-demokrat (BLD), Partia Balli Kombëtar Demokrat (PBKD), Partia e Bashkimit Demokrat Shqiptar (PBDSH), Partia Republikane (PR) dhe Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (LDLNJ).

²⁸ Neni 84.2: "[...] Koalicioni përjashtohet nga detyrimi për firmat, i parashikuar nga ky nen i Kodit, nëse partitë anëtare të tij zotërojnë së bashku mandate në Kuvend në numër jo më të vogël sesa numri i partive anëtare".

KQZ-ja skualifikoi koalicionet PSSH+PUK dhe LDI për parregullsi në listat me firmat mbështetëse. Kolegji Zgjedhor rrëzoi vendimin e KQZ-së për skualifikimin e koalicionit PSSH+PUK²⁹. Në fund, nga 19 partitë që paraqitën kërkesën për të kandiduar në koalicione, 14 arritën të kandidonin në tri koalicione³⁰.

Procesi i kontrollit të firmave mbështetëse nuk ishte i kënaqshëm. Kodi Zgjedhor nuk përcakton metodën me të cilën KQZ-ja duhet të vlerësojë firmat mbështetëse dhe parashikon një periudhë të pamjaftueshme kohe që KQZ-ja t'i shqyrtojë firmat mbështetëse me imtësinë e duhur. Megjithatë, KQZ-ja mund të kishte marrë një vendim mbi këtë çështje përpara fillimit të procesit të verifikimit. Ajo nuk e bëri një gjë të tillë dhe e trajtoi çështjen vetëm pas dorëzimit të listave³¹.

B. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE NË ZONAT NJËMËRORE

Për garën në zonat zgjedhore, kandidatët duhet të regjistrohen në KZZ-në përkatëse. Kandidatëve të partive parlamentare dhe deputetëve të legjislaturës së fundit të zgjedhur si të pavarur nuk u kërkohet të paraqesin firma mbështetëse, ndërsa kandidatët e partive joparlamentare dhe kandidatët e pavarur duhet të paraqesin firmat e 300 zgjedhësve të regjistruar në zonën ku synojnë të konkurrojnë.

KZZ-të regjistruan 1 235 kandidatë në 100 zona njëemërore. Shumë pak kandidatëve të ardhshëm iu mohua regjistrimi nga një KZZ. Sidoqoftë, vëzhguesit vunë në pikëpyetje vendimet e KZZ-së për mosregjistrimin e një numri të vogël të kandidatëve të pavarur. Shtatëmbëdhjetë kërkesa ankimore u depozituan në KQZ në lidhje me regjistrimin e kandidatëve³².

Para zgjedhjeve, PD-ja arriti marrëveshje me shkrim me shtatë partitë e koalicionit ALDM, sipas të cilave, PD-ja dhe secila prej shtatë partive të ALDM-së do të regjistrojnë të paktën një kandidat në garën për zonat njëemërore nën siglën e PD-së. Në fakt, PD-ja paraqiti zyrtarisht 100 kandidatë, siç përcaktohet nga ligji dhe 15 prej tyre u propozuan nga parti aleate të PD-së, në përputhje me marrëveshjet e sipërpërmendura.

²⁹ Kolegji Zgjedhor vendosi se listat e partive duhej të përfshiheshin në fletën e votimit, pasi numri i firmave të dyshimta në to nuk e ulte numrin e kërkuar të asnjë prej listave dhe, si rrjedhim, nuk ekzistonte asnjë bazë objektive për të nxjerrë përfundimin se partitë nuk i kishin përmbushur kriteret e regjistrimit.

³⁰ ALDM-ja regjistroi një listë shumëemërore të përbërë. Në këtë rast, 7 partitë u shënuan veçmas në fletën e votimit, ku tregohet emri i koalicionit dhe emri i partisë përkatëse, çdonjëra prej të cilave kishte kutizën e vet ku mund të shënohej vota. LZHK-ja dhe PSSH+PUK regjistruan lista të përbashkëta shumëemërore. Në këtë rast, vetëm emri i koalicionit u shënuar në fletën e votimit.

³¹ Fillimisht, KQZ-ja kontrolloi dhjetë firma për çdo listë, për të verifikuar nëse nënshkruesit ishin të regjistruar në listën paraprake të zgjedhësve. Më pas, ajo e rriti këtë numër në 50. Kjo metodë ishte e diskutueshme, pasi bëri që KQZ-ja të shpallte të pavlefshme lista të tëra, përfshi firma të vlefshme, duke u nisur nga prania e disa firmave të pavlefshme. Gjithashtu, KQZ-ja i kërkoi ndihmë policisë në kryerjen e kontrollit grafologjik. Ajo konfirmoi se të gjitha listat e dorëzuara përmbanin disa firma të shumëfishta nga i njëjti person. Pranimi i deklaratave noteriale nga persona që kishin firmosur në emër të tjerëve ishte i dyshimtë dhe jo i parashikuar në Kodin Zgjedhor (p.sh. Lidhja e Blertë). Tri partive që ishin të pranishme kur KQZ-ja mori një vendim në lidhje me regjistrimin e tyre iu dha kohë për dorëzimin e dokumentacionit plotësues. Dy prej tyre u pranuan dhe njëra u refuzua. Partitë e tjera që nuk ishin të pranishme në KQZ, kur listat e tyre u hodhën poshtë, u ankuan se u ishte mohuar mundësia për dhënien e dokumenteve plotësuese.

³² Ajo la në fuqi shtatë, rrëzoi katër si të pabazuara dhe dy për mungesë provash. Katër kërkesa ankimore u rrëzuan për procedurë ose u tërhoqën.

Përsa i përket konkurrimit për listat shumëmemërore, PD-ja dhe ALDM-ja regjistruan lista të veçanta kandidatësh. Është me vlerë të vihet në dukje se lista e PR-së, një parti përbërëse e koalicionit ALDM, përmbante emrat e 30 anëtarëve të PD-së, përfshirë deputetë në legjislaturën e fundit, të cilët, në vitin 2001, ishin zgjedhur si kandidatë të PD-së. PS-ja nuk ankimoi vendimin e KQZ-së për regjistrimin e këtyre anëtarëve nën siglën e PD-së.

PS-ja regjistroi 100 kandidatë për zonat zgjedhore. Sidoqoftë, në shumë zona, aleatët e PS-së regjistruan gjithashtu kandidatë për mandate njëmemërore³³. PS-ja dhe pesë aleatët e saj regjistruan gjithashtu lista shumëmemërore të veçanta në garën për 40 mandatet plotësuese në shkallë vendi. LSI-ja konkurroi veçmas nga të gjitha partitë e tjera, ashtu si edhe LZHK-ja.

VII. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

A. KUADRI RREGULLUES

Në periudhën mes muajit tetor të vitit 2004 dhe janar të vitit 2005, legjislacioni që rregullonte regjistrimin e zgjedhësve ishte reformuar dhe përgjegjësia për hartimin dhe përditësimin e listave të zgjedhësve ishte transferuar nga KQZ-ja te njësitë e qeverisjes vendore. Ky ishte një zhvillim i mirëpritur, veçanërisht, duke qenë se qeverisja vendore mban regjistrat me të dhënat e gjendjes civile të popullsisë. Fakti që, proceset e mëparshme zgjedhore ishin njëlloshur në mënyrë të vazhdueshme nga pretendimet se listat ishin të manipuluar politikisht në nivelin qendror, luajti gjithashtu një rol në favor të një qendrimi të decentralizuar.

Për zbatimin e legjislacionit të ri, duhej të kryhej një rishikim i regjistrave të gjendjes civile që mbaheshin dhe përditësoheshin nga njësitë e qeverisjes vendore dhe hartimi i regjistrave të përkohshëm të banorëve në zyrat e gjendjes civile. Për këtë qëllim, në periudhën mes muajit nëntor 2004 dhe shkurt 2005, u krye një proces verifikimi dhe identifikimi derë më derë. Pas identifikimit dhe verifikimit, shtetasve u caktuajt një 'adresë numerike' dhjetëshifrore, në bazë të hartave dixhitale të zonave³⁴. Së dyti, lista të kompjuterizuara zgjedhësish duheshin hartuar nga fillimi, në nivel vendor, mbështetur në regjistrat e gjendjes civile.

Të dyja detyrat duhej të kryheshin nga njësitë e qeverisjes vendore. Megjithatë, edhe pse në një sistem të decentralizuar, ka një numër detyrash, që mund të kryhen vetëm në nivel qendror: sigurimi për zbatimin e një metodologjie të njëjtë nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore dhe kontrolli i listave për të dhëna të mundshme të shumëfishta brenda njësive të qeverisjes vendore dhe midis njësive së qeverisjes vendore. Kodi Zgjedhor (Neni 55 dhe në vijim), ia ka dhënë këtë përgjegjësi Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. Në fillim, MPVD-ja ngurroi të përfshihej në këto detyra. Në ndonjë rast, kjo çoi në udhëzime të vonuara dhe/ose të paqarta, të cilat ndikuan në punën e njësive të qeverisjes vendore dhe, si rrjedhojë, pati mungesë njëtrajtshmërie në zbatim.

Megjithatë, duke përdorur listat paraprake të zgjedhësve të dërguara nga njësitë e qeverisjes vendore, MPVD-ja krijoi një bazë të dhënash për zgjedhësit në shkallë vendi. Roli i MPVD-së kufizohej në identifikimin e të dhënave të shumëfishta dhe udhëzimin e njësive të

³³ PSD-ja, Partia Demokracia Sociale (PDS), PBDNJ-ja, AD-ja dhe PAA-ja

³⁴ Shqipëria është ende në procesin e ngritjes së një sistemi të përshtatshëm adresash. Adresat numerike identifikojnë njësinë e qeverisjes vendore, në të cilën një shtetas është i regjistruar (tri shifra), qendrën e votimit ku caktohet shtetasi (katër shifra) dhe ndërtesën në të cilën banon (tri shifra).

qeverisjes vendore për zgjidhjen e tyre. Në fakt, pavarësisht nga krijimi i një baze të dhënash në shkallë vendi, hartimi dhe përditësimi i listave të zgjedhësve mbeti përgjegjësi e qeverisjes vendore. Më tej, MPVD-ja identifikoi 203 034 'të dhëna të mundshme të shumëfishta' në listat paraprake, që përkonin me rreth 100 000 zgjedhës të regjistruar. Deri më 8 qershor, u korrigjuan të dhënat e 83 630 shtetasve, me qëllim që ata të figuronin të regjistruar vetëm një herë.

Listat paraprake të zgjedhësve duhej të shpalleshin publikisht nga data 1 prill deri më 3 maj, për t'u lejuar shtetasve të kontrollonin të dhënat e tyre. Gjatë kësaj periudhe, zgjedhësit që nuk gjendeshin në listë mund t'i drejtonin një kërkesë kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore për të shtuar emrin e tyre. MPVD-ja e shtyu afatin e periudhës së shpalljes deri më 30 maj. Listat përfundimtare të zgjedhësve u përfunduan më 8 qershor.

Rreth 2,85 milionë shtetas ishin të regjistruar në listën përfundimtare të zgjedhësve. Megjithatë, rreth 470 000 të të dhënave të regjistruara u mungonte adresa e plotë numerike (të ashtuquajturit 'kodet 999'), kryesisht pasi, gjatë procesit të verifikimit derë më derë, ekipet e lëvizshme nuk mundën të kontaktonin disa prej shtetasve, të dhënat e të cilëve ishin të përfshira në regjistrin e gjendjes civile dhe, si rrjedhim, nuk ishin në gjendje të konfirmonin nëse këta shtetas vazhdonin të ishin banues në ndërtesën ku ishin regjistruar. Raste të tilla u shënuan në 291 prej 383 njësive të qeverisjes vendore. Kjo dukuri ishte një problem veçanërisht në zonat urbane, për shkak të migrimit drejt zonave urbane, emigrimit, dhe të ashtuquajturave 'zona informale banimi'. Partitë shprehën shqetësimin se të dhënat me kodin 999 mund t'i hapnin rrugë manipulimit zgjedhor. Shqetësimi u shtua për zonat zgjedhore ku parashikohej një konkurrencë e fortë.

B. VLERËSIMI I PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË ZGJEDHËSVE

Saktësia e listave të zgjedhësve ishte çështje politikisht e debatueshme gjatë periudhës parazgjedhore. Edhe pse krijimi i procedurave të reja të regjistrimit ishte, sigurisht, një zhvillim pozitiv, njësitë e qeverisjes vendore nuk kishin kohën dhe burimet e mjaftueshme për përmbushjen e detyrës. Vëzhguesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it raportuan se pak zgjedhës i kishin kontrolluar të dhënat e tyre në listat përfundimtare të zgjedhësve dhe akoma më pak kishin kërkuar marrjen e një vendimi nga gjykata. Pavarësisht nga të metat në proces, përpjekjet për përmirësimin e listave të zgjedhësve ishin të mirëpritura, domethënëse dhe të suksesshme në një shkallë të gjerë. Sidoqoftë, mosveprimi i vazhdueshëm i autoriteteve shqiptare për reformimin dhe modernizimin e sistemit të gjendjes civile, për të ngritur një sistem uniform të adresave të ndërtesave si dhe për të lëshuar dokumente personale identifikimi, e zbehën domethënien e përpjekjeve.

Ndërsa pjesa më e madhe e vëzhguesve vuri re vetëm pak probleme serioze në lidhje me saktësinë e listave të zgjedhësve, disa prej tyre raportuan të meta të konsiderueshme në zona të veçanta, si p.sh., zonat 5 dhe 6 në Qarkun e Shkodrës, zonat 25 dhe 28 në Qarkun e Durrësit dhe zonat 33 dhe 38 në Qarkun e Tiranës. Në zonën 33, nuk u veprua në lidhje me një numër të madh kërkesash të ligjshme të shtetasve për t'u përfshirë në listat përfundimtare të zgjedhësve. Në të njëjtën zonë si dhe në zonën 38 u ngritën shqetësime serioze në lidhje me heqjen e mundshme të së drejtës së votës të studentëve që nuk gjendeshin në listat paraprake dhe përfundimtare, mbi motive në dukje politike. Mes mangësive të tjera të vërejtura në regjistrimin e zgjedhësve, përfshihen:

- Shkrimi jo i njëtrajtshëm i emrave të shumë zgjedhësve në regjistrat e gjendjes civile dhe listat e zgjedhësve;
- Përqasja jo e njëtrajtshme në caktimin e kodeve 999 për QV-të
- Mosarritja e respektimit të afateve ligjore për shpalljen e listave përfundimtare të zgjedhësve në disa zona;
- Vonesa në pajisjen e partive politike me të dhëna të plota të regjistrimit të zgjedhësve³⁵; dhe
- Numri i lartë i QV-ve ku numri i zgjedhësve të regjistruar e kalonte maksimumin ligjor.

Në fazat e vonshme të procesit parazgjedhor lindi një kundërshti në lidhje me lëshimin e 'certifikatave të lindjes', një prej tri dokumenteve, nëpërmjet të cilave shtetasit mund të provojnë identitetin e tyre në QV³⁶. Më 27 qershor, KQZ-ja reagoi duke miratuar një udhëzim, i cili detyronte zyrtarët e gjendjes civile të mbanin të dhëna për certifikatat e lëshuara për qëllime votimi, dhe u kërkonte KQV-ve të mbanin certifikatat e paraqitura prej zgjedhësve për të vërtetuar identitetin e tyre dhe të deklaronte të pavlefshme certifikatat me disa numra serie që përkonin me ato të certifikatave të papërdorura që rezultonin të zhdukura. Më 1 korrik, me një vendim të veçantë, KQZ-ja përcaktoi se, nëse të paktën dy anëtarë të KQV-së vinin në dyshim identitetin e zgjedhësit, personi në fjalë do të lejohej të votonte, vetëm nëse ai apo ajo mund të paraqisnin një dokument zyrtar identiteti shtesë me fotografi.

VIII. FUSHATA

Fushata ishte e bujshme dhe u zhvillua një numër i madh veprimtarish. Ajo u ofroi zgjedhësve një sasi të madhe informacioni politik. Krahasuar me zgjedhje të mëparshme, kandidatët dhe partitë i kushtuan më shumë kohë paraqitjes së platformave të tyre politike sesa sulmeve verbale ndaj rivalëve. Edhe pse fushatat e PS-së dhe PD-së ishte më intensivët, edhe LSI-ja ishte aktive. Fushatat e PBDNJ-së, LZHK-së dhe PR-së dukej se ishin të përqendruara në zona të veçanta zgjedhore.

ALMD-ja dhe PD-ja zhvilluan shpesh veprimtari të përbashkëta të fushatës, ashtu siç bënë edhe kandidatët e PS-së me partitë e tyre aleate, edhe pse në një shkallë më të vogël. PR-ja i nxiti hapur mbështetësit e saj, përfshi posterat në tabela, për të votuar për kandidatët e PD-së në garën për mandatet njëemërore. Pavarësisht nga mungesa e një marrëveshjeje zyrtare zgjedhore për koalicion mes PS-së dhe aleatëve të saj përpara zgjedhjeve, vëzhguesit e MVZ-së raportuan për thirrje të përsëritura nga politikanët brenda PS-së dhe partive aleate për të votuar për kandidatët e PS-së në zonat njëemërore dhe për listat shumemërore të partive

³⁵ Partitë politike kishin të drejtën të merrnin kopje të listave përfundimtare të zgjedhësve.

³⁶ Në këtë kuadër, termi "certifikatë lindjeje" i referohet një certifikate që provon një të dhënë në regjistrin e gjendjes civile. Certifikatat, që lëshohen nga zyrat e gjendjes civile, janë të vlefshme për një periudhë tremujore dhe kanë fotografinë e personit. Pavarësisht nga miratimi i Ligjit për Kartat e Identitetit, që prej vitit 2002, asnjë kartë identiteti nuk është lëshuar në rreth 10 vjet dhe "certifikatat e lindjes" merren lehtësisht dhe kanë përdorim të gjerë. Vëzhguesit raportuan se, në praktikë, shumë nga njësitë e qeverisjes vendore nuk regjistronin të dhëna mbi certifikatat e lindjes të lëshuara dhe, në disa raste, lëshonin certifikata lindjeje pa kontrollin e duhur. Për shembull, në Shkodër, vëzhguesit u informuan se zyra e gjendjes civile nuk regjistronte të dhëna mbi certifikatat e lindjes që lëshoheshin, dhe se kjo zyrë kishte marrë 110 000 formularë në tetor të vitit 2004, nga të cilat vetëm 20 000 kishin mbetur pa u përdorur. Kjo praktikë e keqe, e ndërthurur me pretendimet për vjedhjen e një numri të konsiderueshëm certifikatash lindjeje të papërdorura dhe shtypja e paligjshme e shpërndarja e një numri edhe më të madh të tyre, shkaktoi shqetësime serioze mes disa partive se mund të shfrytëzoheshin mangësitë në listën e zgjedhësve.

aleate. Thirrje të ngjashme u vunë re edhe në median elektronike dhe fletëpalosje e fushatës të shpërndara në zona të veçanta njëemërore.

Kështu, të dy kampet kryesore politike e bazuan fushatën e tyre, pjesërisht, mbi strategji zgjedhore që sfiduan kufijtë e ligjit, zbehën dallimin mes partive politike dhe kishin mundësi të anashkalonin objektivin e proporcionalitetit "në raport sa më të afërt", siç përshkruhet në dokumentet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it³⁷.

Para fillimit të fushatës zyrtare, gjashtëmbëdhjetë parti politike nënshkruan një Kod Sjelljeje, i hartuar me nismën e Presidentit të Shqipërisë, z. Alfred Moisiu. Nënshkruesit premtuan se do të respektonin ligjin dhe se do të ushtronin vetëpërmbytje gjatë fushatës. Edhe pse Kodi i Sjelljes vendosi 'standarde të rëndësishme për fushatën', nuk u krye asnjë monitorim zyrtar i respektimit të Kodit të Sjelljes. Megjithatë nënshkruesit ranë dakord në përgjithësi me dispozitat e tij, në vazhdim, fushata u bë më e ashpër dhe shumë reklama në media përmbanin 'fushatë negative'.

Kodi Zgjedhor parashikon financim publik të fushatave zgjedhore të partive. KQZ-ja shpërndau 60 000 000 lekë (rreth 480 000 Euro) për këtë qëllim. Përveç fondeve publike, subjektet zgjedhore mund të marrin dhurime private deri në 1 000 000 lekë (8 000 Euro) për çdo dhurim. Disa kandidatë i informuan vëzhguesit se po vetëfinanconin fushatën e tyre. Vëzhguesit në disa zona ishin mjaft kritikë në lidhje me përqasjen e kandidatëve ndaj shpenzimeve për fushatën, veçanërisht në financimin e projekteve në infrastrukturë, si ndërtimi i rrugëve, për të cilat pretendonin se financoheshin nga fonde personale.

Edhe pse liria e shprehjes, e drejta e organizimit dhe tubimit paqësor u respektuan në pjesën më të madhe gjatë fushatës, vëzhguesit morën shumë pretendime dhe njoftime në lidhje me mangësi serioze, disa prej të cilave binin ndesh drejtpërdrejtë me këto të drejta:

- Megjithatë më pak të përhapura se në zgjedhje të mëparshme, disa incidente të dhunshme e njollosën fushatën;³⁸
- Shumë pretendime u ngritën në lidhje me faktin se mbi nëpunësit publikë ushtrohej presion për të marrë pjesë në veprimtaritë e fushatës, për të mbështetur kandidatë apo parti të veçanta ose për të mos mbështetur të tjera;
- Pretendime se mbi studentët ushtrohej presion për mbështetjen e anëtarëve të personelit të universitetit që kandidonin;
- U morën raportime të besueshme se mësuesit sillnin fëmijët e shkollave në mitingjet e fushatës;
- Në 12 zona zgjedhore, vëzhguesit morën pretendime, disa prej të cilave të besueshme, se policia ushtronte presion mbi shtetasit gjatë veprimtarisë së tyre politike, si dhe nuk veprroi ndaj shkeljes së rregullave të fushatës dhe pretendimit të disa zgjedhësve se ishin kërcënuar;
- Në rreth një të katërtën e zonave zgjedhore vëzhguesit morën pretendime se shtetasit merrnin ose u ofroheshin dhurata ose para për të mbështetur një kandidat të caktuar; dhe

³⁷ Shih Raportin e OSBE/ODIHR-it mbi Misionin e Vlerësimit të Nevojave për Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005 në Shqipëri, f 5-6; dhe Raportin e Ndërmjetëm nr. 2 të MVZ-së së OSBE-ODIHR-it, Shtojcë 1.

³⁸ Për shembull, në Shijak (ZZ 26), ku mbështetësit e PS-së hynë me forcë në një ndërtesë private dhe sulmuan të pranishmit për shkak se kishin vendosur postera të opozitës si dhe në Fier, Korçë, Laç, Shkodër dhe Tiranë ku zyrtarë paritake u bënë pre e vandalizmave.

- Shembja e ndërtesave me urdhër të strukturave të pushtetit vendor, përfshi një zyrë zgjedhore të LSI-së dhe një shtëpi, pronë e kryetarit të bashkisë së Sarandës (PD), përpara shqyrtimit të ankesave ndaj urdhrave për shembje, mund të ketë qenë e motivuar politikisht.

Kandidatë të cilët mbanin poste të caktuara zyrtare, në përputhje me Nenin 69 të Kushtetutës, dhanë dorëheqjen. Sidoqoftë, partitë e opozitës dhe partia në pushtet u ankuan publikisht mbi konflikte të mundshme interesash dhe shpërdorimin e burimeve administrative nga kandidatët. Në thuajse gjysmën e zonave zgjedhore, vëzhguesit u njohën me pretendime në lidhje me faktin se burimet administrative përdorreshin për qëllime fushate, apo se nëpunësit publikë po bënë fushatë për kandidatët.

IX. MEDIA

A. KUADRI RREGULLUES

Kodi Zgjedhor rregullon pasqyrimin e fushatës zgjedhore nga media. Dispozitat rregullojnë pothuajse vetëm median elektronike. Kodi parashikon në mënyrë të qartë sanksionet e zbatueshme, në rast të mospërputhjes me rregullat. Dispozitat mbi median u zbatuan vetëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës, nga tre qershori deri më 1 korrik. Media e shkruar nuk është subjekt i asnjë rregullimi, përjashtojë detyrimin për të respektuar periudhën e heshtjes zgjedhore në ditën përpara ditës së zgjedhjeve.

Kodi kërkon që media elektronike publike t'i ofrojë minutazh falas secilës parti që merr pjesë në zgjedhje. Ndarja e kohës bëhet në varësi të përmasave të përfaqësimit të partisë në Kuvend, duke i ndarë ato në tri kategori: ato me mbi 20 % të vendeve në Kuvend (këtej e tutje: partitë e mëdha), ato me më pak se 20% të vendeve (këtej e tutje: parti të vogla) dhe partitë joparlamentare.

Përveç kësaj, si medias private edhe asaj publike i kërkohet të pasqyrojë fushatën e partive në programet e lajmeve, me minutazh transmetimi sipas peshës së përfaqësimit të partisë në Kuvend. Koha e përgjithshme që i ofrohet secilës prej partive 'të mëdha' parlamentare duhet të jetë "sa dyfishi i minutazhit që u caktohet partive 'të vogla' parlamentare".

Media private mund të transmetojë me pagesë hapësira për fushatën, ku partitë e mëdha parlamentare kanë të drejtë të blejnë dyfishin e minutazhit së transmetimit të partive të vogla, duke i diskriminuar këto të fundit.

Në përputhje me legjislacionin, KQZ-ja ngriti Bordin për Monitorimin e Medias (BMM) për të mbikëqyrur zbatimin e Kodit nga media. Përveç kësaj, monitoruesit lokalë u caktuan të vlerësonin nivelin lokal të pasqyrimin të fushatës. Veprimtaritë e monitoruesve lokalë u penguan nga vonesat në caktimin e tyre. BMM-ja përgatiti raporte ditore për KQZ-në, në lidhje me masën e pasqyrimin për çdo subjekt zgjedhor. Pavarësisht nga disa mangësi procedurore dhe metodologjike, BMM-ja e përmbushi efektivisht mandatin e saj³⁹. KQZ-ja i përdori raportet e BMM-së për të shqyrtuar ankimet në lidhje me pasqyrimin e fushatës në

³⁹ Mangësitë përfshinin një keqinterpretim të dukshëm të Nenit 140, ku BMM-ja përfshiu reklamat me pagesë në llogaritjen e minutazhit televiziv për partitë, si edhe nuk paraqiti të dhënat në mënyrë të njëtrajtshme.

media⁴⁰. KQZ-ja nxori disa paralajmërime zyrtare për organe të medias dhe i kërkoi medias të trajtonte pabarazinë në pasqyrimin e fushatës nëpërmjet dhënies së minutazhit 'shpesë' të transmetimit.

B. MONITORIMI I MEDIAS

Më 17 maj, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it filloi monitorimin e tri kanaleve kombëtare televizive në periudhën kohore prej orës 18:00 deri në orën 24:00. Këtu u përfshi TVSH-ja, që financohet kryesisht nga buxheti i shtetit, TV Arbëria dhe TV Klani, të dyja televizione private. Përveç kësaj, monitoroi edhe programin kryesor të lajmeve në Top Channel dhe gjashtë gazeta të përditshme, "*Shekulli*", "*Panorama*", "*Korrieri*", "*Gazeta Shqiptare*", "*Tema*" dhe "*Koha Jonë*".

Në përgjithësi, media e shkruar dhe elektronike siguroi një pasqyrim zgjedhor të plotë dhe një gamë të larmishme të opinioneve politike. Stacionet kryesore televizive transmetuan shpesh programe për çështjet e ditës dhe diskutime politike që përqendroheshin në fushatat e partive. Megjithatë, këto programe prireshin të ofronin një forum kryesisht për PS-në dhe PD-në dhe, në një shkallë më të ulët, për LSI-në dhe LZHK-në. Pozitiv ishte fakti se edhe disa stacione televizive lokale transmetuan debate midis kandidatëve. Për t'u ardhur keq ishte fakti se një debat i shumëpritur televiziv midis Fatos Nanos dhe Sali Berishës nuk arriti të zhvillohej. Kjo ishte një mundësi e humbur që dy udhëheqësit politikë të paraqisin pikëpamjet e tyre. Me afrimin e ditës së zgjedhjeve, media transmetoi informacione për zgjedhësit dhe mesazhe ku shtetasit nxiteshin të votonin.

Përpara fillimit të periudhës zyrtare të fushatës, media ofroi pasqyrim të gjerë të zgjedhjeve dhe TVSH-ja i dha qeverisë një mbulim favorizues - 46 % të të gjithë kohës kushtuar politikës. Mediat e tjera elektronike të monitoruara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it kishin prirje për ta përqëndruar pasqyrimin e tyre mbi qeverinë dhe PS-në e PD-në. Përpara fillimit të periudhës zyrtare të fushatës, LSI-së iu dha afërsisht 10% e minutazhit politik në lajmet kryesore në TV Klan dhe Top Channel, por ky pasqyrim ishte i papërfillshëm në TVSH dhe TV Arbëria.

Në fillim të periudhës zyrtare të fushatës, TVSH-ja u siguroi minutazh transmetimi falas partive, siç parashikohej nga ligji. Pasqyrimi i PS-së dhe PD-së në emisionet e saj të lajmeve ishte më i ekuilibruar, ku PD-së iu dha 19% e minutazhit të transmetimit dhe PS-së 16 %⁴¹. Toni i pasqyrimin të të gjitha partive në programet e lajmeve e TVSH-së ishte ose politikisht asnjës, ose me ngjyrimet pozitive. Gjithashtu, PS-së dhe PD-së iu dha përgjithësisht një minutazh i barabartë në programet e lajmeve të kanaleve private të monitoruara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it⁴². Në përgjithësi, ato bënë një pasqyrim politikisht të paanshëm të partive dhe vepruan në përputhje me ndalimin ligjor të "propagandës, komenteve dhe qëndrimeve politike" gjatë emisioneve të lajmeve (Neni 140.2.ç).

⁴⁰ Partitë depozituan disa ankime zyrtare në KQZ, në lidhje me pretendimet për pasqyrim të padrejtë apo të paligjshëm. Partitë e vogla ishin aktive në ankime veçanërisht ndaj minutazhit të papërfillshme të pasqyrimin që u ishte dhënë. PD-ja kërkoi, gjithashtu, kohë transmetimi shpesë për të kompensuar kohën që iu dha PS-së në fillim të fushatës.

⁴¹ Gjatë kohës së fushatës, shifrat për minutazhin e transmetimit për PS-në përfshijnë pasqyrimin e ministrave kandidatë.

⁴² TV Klani i dha 27 % PD-së dhe 29 % PS-së nga minutazhi për çështjet politike në emisionet e lajmeve. TV Arberia i dha 27 % PD-së dhe 26 % PS-së. Top Channel i dha 28 % PD-së dhe 24 % PS-së.

Sidoqoftë, media nuk veproi në përputhje me dispozitën ligjore që rregullon ndarjen e minutazhit midis partive të mëdha dhe të vogla. Në fakt, të gjitha mediat elektronike të monitoruara iu dhanë një pjesë e madhe e kohës në mënyrë të shpërpjestuar PS-së dhe PD-së. Përveç kësaj, monitorimi nxori në pah se ekzistonte pabarazi mes partive të vogla, disa prej të cilave, u pasqyruan shumë më pak se të tjerat. Këto çështje viheshin shpesh në dukje në raportet e BMM-së për KQZ-në dhe disa kërkuar kohë televizive shtesë. Sidoqoftë, debati publik mbi ekulibrin politik të medias prirej të përqendrohej në barazinë e pasqyrimin mes PD-së dhe PS-së. Kjo e fundit pati numrin më të madh të reklamave me pagesë. Në të njëjtën kohë, PD-ja dhe LSI-ja e ushtruan gjerësisht të drejtën e tyre për transmetimin e mesazheve me pagesë për fushatën.

Gazetat iu ofruan zgjedhësve një larmi këndvështrimesh politike. Sidoqoftë, media e shkruar u përqëndrua, përgjithësisht, në garën mes dy partive më të mëdha, ku disa prej tyre shfaqën dukshëm linja redaksionale partiake dhe kritika të ashpra për parti të caktuara. Disa organe të shtypit të shkruar nuk e respektuan periudhën e heshtjes zgjedhore.

X. ANKIMET DHE APELIMET ZGJEDHORE PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

Partitë politike, koalicionet dhe kandidatët kishin të drejtë të kërkonin shqyrtimin gjyqësor të një vendimi të KQZ-së duke depozituar një kërkesëpadi në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit të Tiranës⁴³. Para ditës së zgjedhjeve, në Kolegjin zgjedhor u paraqitën 34 kërkesëpadi kundër vendimeve të KQZ-së. Gjykata rrëzoi nëntë vendime të KQZ-së⁴⁴, ktheu dy prej tyre në KQZ për rishqyrtim të mëtejshëm dhe pjesën tjetër të ankimeve ose i pushoi, ose i la në fuqi. Vëzhguesit ndoqën pjesën më të madhe të çështjeve të shqyrtuara nga Kolegji Zgjedhor. Gjatë seancave apo marrjes së vendimeve nuk u vu re njëanshmëri politike. Të gjitha partive iu dha një mundësi e barabartë për të paraqitur pretendimet e tyre dhe, në disa raste, edhe një shtyrje e seancës, me qëllim sigurimin e provave të nevojshme. Në përgjithësi, përpara zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor e përmbushi detyrinin e tij për gjykimin e drejtë dhe të paanshëm të ankimeve.

Neni 60 i njeh një shtetasi me të drejtë vote, i cili nuk gjendet në një listë zgjedhësish, të drejtën për t'i kërkuar gjykatës së rrethit gjyqësor të përfshihet në listë. Kjo është e vetmja dispozitë që u jep shtetasve një zgjidhje ligjore. Sidoqoftë, ajo nuk saktëson se çfarë dokumentesh duhet të paraqesë shtetasi në gjykatë për të provuar të drejtën e tij. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejti se gjykatat e rretheve gjyqësore nuk mbajtën një qendrim të njëtrajtshëm, në një kohë që disa prej tyre kërkonin dokumente që nuk kërkoheshin nga gjykata të tjera.

Ankimi më i diskutueshëm parazgjedhor kishte të bënte me një vendim të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr. 2 (Tiranë) për mosregjistrimin e 1 422 studentëve si zgjedhës. Si rrjedhim, studentët nuk mundën ta ushtronin të drejtën e votimit në Tiranë⁴⁵. Duke qenë se stafi i universitetit kishte programuar provime në ditën e zgjedhjeve, studentët nuk mund të

⁴³ Kolegji Zgjedhor, i cili përbëhet nga tetë gjyqtarë të zgjedhur me short nga një grup i të gjithë gjyqtarëve të apelit në Shqipëri, vendos mbi çështjet me anë të një trupi gjykues prej pesë anëtarësh, edhe këta të zgjedhur me short.

⁴⁴ Pesë ankime të suksesshme kishin lidhje me vendimet e KQZ-së për mosregjistrimin e listave shumëmemërore të partive. Tri ankime të suksesshme kishin lidhje me regjistrimin e kandidatëve të pavarur në zonat njëmemërore. Një ankim i suksesshëm kishte lidhje me mënyrën e renditjes të partive dhe koalicioneve në fletën e votimit.

⁴⁵ Një prej dekanëve të Universitetit të Tiranës ishte kandidat i PD-së dhe Kryetari ishte i zgjedhur nën siglën e PS-së.

kttheheshin në vendbanimet e tyre të përhershme dhe, në fakt, iu mohua e drejtat e votës. Pesë studentë ankimuan vendimin e kryetarit të njësisë bashkiake në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Më 9 qershor, Gjykata vendosi në favor të studentëve dhe anuloi vendimin e kryetarit. Sidoqoftë, ajo vetëm urdhëroi regjistrimin e pesë studentëve, të cilët kishin depozituar ankimin. Edhe këta persona nuk u regjistruan për të votuar, pasi listat përfundimtare të zgjedhësve ishin shtypur tashmë. Ishte për të ardhur vërtet keq që këta studentë u lanë jashtë listës së zgjedhësve, për shkak të veprimeve të autoriteteve qeveritare. Edhe pse KQZ-ja i vendosi kryetarit të njësisë bashkiake një gjobë prej 80 000 lekësh (afërsisht 670 Euro) për veprimet që çuan në heqjen e të drejtës së votës të këtyre zgjedhësve, ky ndëshkim duket modest krahasuar me shkeljen.

XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE

Për pakicat kombëtare në Shqipëri ka një mungesë të të dhënave zyrtare aktuale të besueshme. Megjithatë, është e njohur gjerësisht se bashkësitë greqishtfolëse banojnë në rajone të Shqipërisë së Jugut dhe bashkësitë rome dhe egjiptiane banojnë në qytete dhe fshatra në mbarë Shqipërinë. Pakica të tjera përfshijnë arumunët (vllehët), maqedonasit dhe serbët e malazezët, ku dy pakicat e fundit banojnë kryesisht të përqendruara në komuna të veçanta.

Në vitin 2004, qeveria miratoi ngritjen e Komitetit të Posaçëm Shtetëror për Pakicat, i ngarkuar për të bërë rekomandime mbi nxitjen e të drejtave të disa pakicave. Pozita e disa pakicave është përmirësuar, pjesërisht përmes nismave të vetë atyre për të krijuar ose zhvilluar shoqata politike, si dhe përmes përpjekjeve të tyre për mbrojtjen e të drejtave. Nuk ka asnjë pengesë ligjore për krijimin e partive politike mbi baza etnike, fetare apo krahinore, me kusht që partia të mos përfshihet në urrejtje racore, fetare, krahinore, apo etnike. Kohët e fundit, Aleanca Maqedonase për Integrim Evropian ishte e para parti "me baza etnike" që u regjistrua, e cila kërkon të mbrojë të drejtat e kësaj pakice.

Tradicionalisht, PBDNJ-ja ka kërkuar mbështetjen politike të popullsisë së pakicave. Sidoqoftë, gjatë fushatës zgjedhore, ajo i kushtoi pak vëmendje çështjeve të pakicave. MVZ-ja vërejti se, gjatë fushatës zgjedhore, PD-ja komentoi problemet sociale me të cilat përballen komunitetet rome dhe egjiptiane. Gjithësesi, Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (LDLNJ), e krijuar pas ndarjes nga PBDNJ-ja, ishte e vetmja parti, platforma e së cilës përfshinte thirrje për zbatim të të drejtave të pakicave.

Në disa komuna, vëzhguesit morën pretendime të besueshme se ishin bërë përpjekje të paligjshme për të ndikuar mbi zgjedhjet elektorale të zgjedhësve romë dhe egjiptianë, në veçanti nëpërmjet kërcënimit dhe "blerjes së votës".

Në përgjithësi, media i kushtoi pak vëmendje pjesëmarrjes së pakicave në zgjedhje dhe shumë pak kandidatë nga pakicat u ftuan të merrnin pjesë në debate televizive. Në disa zona zgjedhore, vëzhguesit vërejtën materiale zgjedhore në gjuhët greke dhe maqedonase. Ndonëse KQZ-ja vendosi disa njoftime informuese publike në gjuhët e pakicave në median vendore (greqisht, maqedonisht dhe serbisht), materialet zgjedhore, duke përfshirë edhe fletët e votimit, u shtypën vetëm në gjuhën shqipe.

Kuvendi i ri përfshin katër deputetë nga pakica greqishtfolëse. Megjithatë, është veçanërisht e dukshme se në Kuvend nuk ka deputetë që vijnë nga pakicat rome dhe egjiptiane.

XII. PJESËMARRJA E GRAVE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejta të barabarta për gratë dhe burrat. Megjithatë, gratë janë të nënpërfaqësuar në mënyrë të ndjeshme dhe të vazhdueshme në jetën publike shqiptare. Nëse ka ndonjë prirje, ajo është dukshëm negative. Që prej zgjedhjeve të para shumëpartiake në vitin 1991, përfaqësimi i grave në Kuvend është ulur pas secilës prej gjashtë zgjedhjeve për Kuvendin, duke arritur pikën më të ulët në vitin 2001 me vetëm 8 gra deputete (5,7%).⁴⁶ Në vitin 1991, shifra përkatëse ishte 20,5%.

Megjithëse partitë e mëdha nënshkruan një Kod Sjelljeje, i cili *ndër të tjera* shprehet: "Ne do të nxisim dhe mbështesim konkretisht pjesëmarrjen e plotë të grave, qoftë si kandidatë edhe si anëtare të komisioneve në procesin zgjedhor", asnjë nismë domethënëse nuk u ndërmor në këtë drejtim. Politikanëve meshkuj iu dha 95% e minutazhit politik në media. Partitë nuk bënë pothuajse asnjë përpjekje për të përfshirë gratë në struktura partiake, apo për të përzgjedhur kandidatë femra. Në zonat njëemërore, PS-ja kandidoi me tetë gra, ndërsa PD-ja me vetëm tri. Megjithëse PS-ja dhe PD-ja kishin një numër të lartë grash në listat e tyre shumëemërore, thirrja ndaj mbështetësve të tyre për të votuar për listat shumëemërore të partive të tjera, e ktheu këtë fakt në një veprim tërësisht të pavlerë.

Nga 38 partitë që morën pjesë në zgjedhjet e vitit 2005, kryetarja e vetëm njëres prej partive, Lidhja e Blertë Shqiptare, ishte grua. Në këto zgjedhje u vërejt vetëm një rritje e papërfillshme në numrin e grave të zgjedhura – 10 (7,1%) dhe zgjedhjet e vitit 2005 mund të shihen si një tjetër mundësi e humbur për të trajtuar këtë problem. Të tria kandidatet gra të PD-së, duke përfshirë edhe Jozefina Topallin, zëvendërkryetare e PD-së, e cila mori mbi 60% të votave në zonën e saj, si dhe katër nga tetë gratë kandidatë të PS-së u zgjedhën deputete.⁴⁷ Në koalicionin qeverisës, vetëm katër deputete janë gra. Ndër partitë e opozitës, PS-ja numëron katër gra deputete dhe dy nga shtatë deputetët e PSD-së janë gra. Tetë parti parlamentare nuk kanë asnjë deputete grua në radhët e tyre.

Vetëm katër prej 100 kryetarëve të KZZ-ve të propozuar nga partitë politike dhe më pak se 16% të kryetarëve të KQV-ve ishin gra. Vëzhguesit raportuan raste të shumta, kryesisht në zonat rurale, ku burrat dhe gratë votonin së bashku ose ku burrit i jepeshin dy fletë votimi. Kjo ngre shqetësime serioze përse i përket mohimit të së drejtës së votës për disa gra.

XIII. SHOQËRIA CIVILE DHE VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor është në përputhje me Paragrafin 8 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së (1990), duke parashikuar vëzhgim të zgjedhjeve nga parti politike, OJF vendase dhe organizata ndërkombëtare.⁴⁸ Për kërkesat për akreditim, KQZ-ja duhet të marrë një vendim brenda pesë ditëve nga paraqitja e tyre. Refuzimi për të dhënë akreditim mund të ankimohet. Megjithëse ligji parashikon një kuadër të qartë për vëzhgimin vendas dhe ndërkombëtar të zgjedhjeve, ai bën dallime të panevojshme midis tyre, gjë që, deri në një farë mase, mund të

⁴⁶ Pas vitit 2001, një tjetër grua u zgjedh deputete gjatë mandatit të këtij Kuvendi, duke e çuar numrin në 9 deputete (6,4%).

⁴⁷ Znj. Topalli do të mbajë postin më të lartë në Kuvendin e ri: Kryetare e Kuvendit.

⁴⁸ KQZ-ja miratoi një Udhëzim që shtjellonte më tej kriteret dhe rregullat për vëzhgimin e zgjedhjeve.

zvogëlojë qëllimin e vëzhgimit vendas.⁴⁹ KQZ-ja mbajti një qëndrim të hapur dhe jo të ngurtë për akreditimin e vëzhguesve, duke përfshirë edhe zgjedhjet e përsëritura më 21 gusht. (Shih pikën XVI). Shumë pak kërkesa për akreditim u rrëzuan, të gjitha mbi baza të arsyeshme. Sidoqoftë, pati vonesë në akreditimin e vëzhguesve nga një koalicion i përkohshëm i OJF-ve, për shkak të pështjellimit në lidhje me emrin me të cilin duhej regjistruar koalicioni.

Një numër relativisht i lartë vëzhguesish jopartiakë vendas u akredituan për zgjedhjet e 3 korrikut. Organizatat më të mëdha të akredituara nga KQZ-ja ishin "Forumi i Vëzhguesve Vendas", i drejtuar nga Koalicioni Shqiptar kundër Korrupsionit, si dhe Këshilli Rinor Shqiptar, që akredituan përkatësisht rreth 2 500 dhe 1 000 vëzhgues.

XIV. VËZHGIMI I VOTIMIT DHE NUMËRIMIT

A. VOTIMI

Megjithëse dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë, një numër i vogël incidentesh të dhunshme e njollosën procesin, duke përfshirë incidentin vdekjeprurës me armë zjarri ndaj një vëzhguesi partiak në afërsi të një qendre votimi (QV) në zonën 37, si dhe ndërprerje nga njerëz të armatosur në zonën 65. Një situatë e ngjashme u raportua nga vëzhguesit e MNVZ-së në zonën 26, duke sjellë ndërprerje në veprimtarinë e tyre vëzhguese. Vëzhguesit në zonat 38, 63 dhe 79 raportuan incidente në lidhje me rendin publik. Pretendime të partive politike për incidente të dhunshme në zonat 4, 10 dhe 34 nuk mundën të verifikoheshin. Megjithatë, vëzhguesit raportuan 14 incidente të dhunshme në QV, megjithëse vetëm pak prej tyre ishin të rënda.

Në tërësi, vëzhguesit e vlerësuan pozitivisht votimin në 67 për qind të QV-ve të vizituara dhe vërejtën probleme domethënëse në 11 për qind të QV-ve të vizituara. Ndonëse u raportua një atmosferë e tensionuar në 11 për qind të QV-ve të vizituara, shumica dërrmuese e anëtarëve të KQV-ve të vizituara, 96 përqind, bashkëpunonin mirë me njeri-tjetrin për zhvillimin e votimit. Megjithatë, vëzhguesit vërejtën se në pothuajse katër për qind të QV-ve, persona të paautorizuar ndërhyjnë në procesin e votimit.

Një numër i konsiderueshëm i QV-ve nuk u hapën në kohë. Probleme të veçanta u vërejtën në zonat 26 dhe 2. Në këtë të fundit, 19 nga 70 QV nuk u hapën fare, duke çuar në anulimin e procesit të votimit. Ndërprerjet në votim u vërejtën në 8 përqind të QV-ve të vizituara. Hyrja në QV ishte i vështirë në 14 për qind të QV-ve të vizituara dhe rreth 9 për qind ishin të tejmbushura me njerëz.

Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se në 51 për qind të QV-ve, disa zgjedhës ishin kthyer mbrapsht për shkak se emrat e tyre nuk ishin përfshirë në listën e zgjedhësve të QV-së.⁵⁰ Megjithëse kjo shifër duket e lartë, në më të shumtën e rasteve u prek një numër i vogël shtetasish dhe problemi ishte më pak i shpeshtë se në zgjedhje të mëparshme. Megjithatë, mbetet shqetësim se disa vëzhgues vërejtën mospërputhje të listës përfundimtare të zgjedhësve të afishuar në QV me ato që u ishin dhënë KQV-ve. Vëzhguesit raportuan disa

⁴⁹ Vëzhguesit vendas mund të paraqesin kërkesë për akreditim jo më herët se 45 ditë dhe jo më vonë se 15 ditë para ditës së zgjedhjeve, ndërkohë që vëzhguesit ndërkombëtarë nuk kanë kufizime se sa herët mund të paraqesin kërkesë për akreditim, e cila, në këtë rast, mund të paraqitet deri në 72 orë para ditës së zgjedhjeve.

⁵⁰ Aty ku ndodhën probleme të tilla, shumë KQV i drejtuan shtetasit në pikat e informacionit për të kontrolluar regjistrimin e tyre.

raste ku një numër i vogël shtetasish nuk u lejuan të votonin, për shkak të gabimeve në shkrimin e emrit të tyre.

Në përgjithësi, policia respektoi detyrimin ligjor për të qendruar jashtë QV-ve, përveç rasteve kur prania e tyre kërkohej në mënyrë të posaçme dhe, ndryshe nga zgjedhje të mëparshme, policia nuk ndërhyri në procesin zgjedhor. Vëzhguesit e MNVZ-së identifikuan vëzhgues jopartiakë vendas në 28 përqind të QV-ve, ndërsa në 94 përqind të tyre ishin të pranishëm vëzhgues partiakë.

MVZ-ja mori pretendime, nga burime të ndryshme, për parregullsi të rënda zgjedhore, përfshirë blerjen e votës. Megjithatë, pak pretendime u mbështetën me prova apo u vëzhguan drejtpërdrejt. Pavarësisht nga polemikat në periudhën para ditës së zgjedhjeve, në këtë ditë, vëzhguesit morën, vetëm në raste të rralla, pretendime për keqpërdorimin e certifikatave të lindjes. Pjesa më e madhe e KQV-ve zbatoi vendimet e KQZ-së për të mbajtur certifikatat dhe për të kërkuar dokumente identifikimi shtesë, nëse ekzistonte dyshimi për identitetin e zgjedhësit.

Megjithëse procedurat, si për shembull, vulosja e duhur e kutive të votimit, u respektuan në përgjithësi, të tjera procedura nuk u respektuan. Vëzhguesit vërejtën se dokumentet e identifikimit të zgjedhësve nuk u kontrolluan si duhet në 6 përqind të QV-ve të vizituara, kryesisht në zonat rurale. Zgjedhësit u kontrolluan rrallë ose asnjëherë për bojën e padukshme në 19 përqind të QV-ve të vizituara dhe boja nuk u përdor në 11 përqind të QV-ve të vizituara. Kjo zvogëloi efikasitetin e elementeve të rëndësishme të sigurisë kundër votimit të shumëfishtë. Në 5 përqind të QV-ve, zgjedhësit nuk nënshkruan apo emrit të tyre nuk iu vizë në listën e zgjedhësve. Kjo mund të ketë ndërlikuar rakordin me numrin e fletëve të votimit dhe mund të shpjegojë disa nga mospërputhjet e vëna re më vonë midis numrit të nënshkrimeve në listën e zgjedhësve dhe numrit të fletëve të votimit të gjetura në kutitë e votimit. Pas mbylljes së votimit, vëzhguesit vërejtën se kopje të procesverbaleve të mbajtura nga KQV-të gjatë ditës së zgjedhjeve nuk iu dhanë gjithmonë atyre që kishin të drejtë t'i marrnin.

Në 13 përqind të QV-ve të vizituara, fshehtësia e votës nuk u respektua mjaftueshëm. I ashtuquajtur "votim familjar" u vëzhgua në 10 përqind të QV-ve të vizituara. Megjithëse "votimi familjar" ndodhi më rrallë se në të shkuarën, mbetet si problem, veçanërisht në zonat rurale. Një risi e mirëpritur ishin dispozitat e reja që lejonin të verbërit të votonin pa ndihmë. Megjithatë, nuk ekzistojnë dispozita për të siguruar që shtetasit, të cilët nuk mund të dalin nga shtëpia, të mund të ushtrojnë të drejtën e votës nëpërmjet një kutie lëvizëse.

B. NUMËRIMI

Për herë të parë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, votat u numëruan në Vendet e Numërimit të Votave (VNV) dhe jo në QV. Vëzhguesit e MNVZ-së ishin të pranishëm vazhdimisht në 82 nga 100 VNV për të vëzhguar dorëzimin e materialit zgjedhor, numërimin e votave dhe përpilimin e tabelave të rezultateve dhe ishin të pranishëm për të paktën një pjesë të procesit në 15 VNV të tjera.

Shumica e Vendeve të Numërimit të Votave kishin mjedise të mjaftueshme për këtë qëllim, megjithëse, në 25 përqind të rasteve të vëzhguara, vëzhguesit raportuan se mjediset ishin shumë të vogla. Në 29 përqind të rasteve të marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore u

raportua një atmosfere e tensionuar dhe dy incidente të dhunshme. Në disa VNV, dorëzimi i materialeve ishte kaotik. Në 31 zona, vëzhguesit raportuan se një numër i vogël kutish votimi u konsideruan si "të parregullta", për shembull kur mungonin vulat e sigurisë, apo kodet e tyre nuk përputheshin me procesverbalin, ose kur kutitë ishin dëmtuar, ose nuk ishin mbyllur si duhet. Ligji parashikon që këto kuti të dërgohen për në KQZ për hetim të mëtejshëm. Vëzhguesit raportuan se jo të gjitha kutitë e parregullta u identifikuan dhe siguruan, sipas kërkesave ligji. Një numër i madh i KQV-ve, sidomos në zonat malore, nuk arritën të dorëzonin materialet zgjedhore në Vendet e Numërimit të Votave brenda afatit ligjor të orës 22.00 të datës 3 korrik.

Trajnimi i grupeve të numërimit (GN) filloi vonë, për shkak të afateve të shkurtra ligjore për emërimin e anëtarëve të GN-ve dhe, në disa raste, për shkak të arritjes të tyre me vonesë. Për rrjedhojë, shumë GN nuk ishin të përgatitura plotësisht për detyrat e tyre. Me fillimin e numërimit, vëzhguesit raportuan shpesh se largësia midis zonës së caktuar për vëzhguesit dhe tryezave të numërimit pengonte vëzhgimin e duhur të punës së GN-ve. Në rreth 20 VNV, vëzhguesit raportuan se procesit i mungonte transparenca.

Megjithëse numërimi filloi përgjithësisht vonë natën e zgjedhjeve, në pothuajse të gjitha Vendet e Numërimit të Votave, procesi zgjati më shumë nga sa ishte parashikuar në Kodin Zgjedhor (ora 17.00 e datës 4 korrik). Në shumë zona, procesi i numërimit u tejzgjat dhe u deshën 3 ditë deri në përfundimin e tij. Në pak zona, numërimi zgjati edhe më shumë. Deri në fund të datës 6 korrik, KQZ-ja kishte njoftuar rezultatin e afro gjysmës së zonave njëemërore, mbështetur në tabelat e rezultateve të paraqitura nga KZZ-të. Në këtë kohë, vëzhguesit raportuan se në 20 zona zgjedhore, numërimi ose nuk kishte përfunduar, ose KZZ-ja duhej ende të përpilonte tabelën me rezultatet ose për zonën njëemërore, ose për listat shumëemërore, ose për të dyja. Në mbasditen e datës 8 korrik, katër ditë pas afatit ligjor, mungonin rezultatet përmbledhëse për kandidatë nga tetë zona, si dhe rezultatet për listat shumëemërore nga nëntë zona. Deri më 11 korrik, një javë pas afatit ligjor, tri KZZ duhej ende të dërgonin tabelat përmbledhëse të rezultateve për zonat zgjedhore njëemërore dhe dy KZZ për listat shumëemërore.

Kohëzgjatja e procesit u shkaktoi një tension të konsiderueshëm KZZ-ve dhe GN-ve. Ndonëse disa vonesa ishin për shkak të lodhjes, në pjesën më të madhe ato erdhën për shkak se anëtarët e GN-ve dhe KZZ-ve, sidomos nga dy partitë më të mëdha, penguan përfundimin e numërimit të votave apo përpilimin zyrtar të tabelave të rezultateve dhe disa herë ndërprejnë procesin duke përdorur "largimin". Duke vepruar kështu, këta persona vendosnin interesat e partive mbi detyrën e tyre për të shërbyer si zyrtarë të paanshëm zgjedhorë. Me kalimin e kohës, procesi i numërimit erdhi duke u bërë më polemik. Shpesh, lindën mosmarrëveshje mbi vlefshmërinë e votave.⁵¹ Probleme të tjera lindën për shkak të mospërputhjeve të numrit të zgjedhësve që kishin nënshkruar në listat e zgjedhësve me numrin e fletëve të gjetura në kutitë e votimit.

Vëzhguesit raportuan disa parregullsi serioze, në veçanti në lidhje me listat shumëemërore në zonat ku u vonua përfundimi i numërimit. Këtu përfshihen nëntë zona ku vëzhguesit raportuan se votat nuk po numëroheshin me ndershmëri, siç kërkohet nga paragrafi 7.4 i

⁵¹ Në rreth 15% të zonave të vizituara, vëzhguesit raportuan se GN-të nuk i kryen detyrat me paanshmëri politike.

Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së, i vitit 1990.⁵² Pretendime të ngjashme iu paraqitën vëzhguesve në dhjetë zona të tjera.⁵³ Më vonë, LSI-ja, LZHK-ja, AD-ja dhe PDS-ja pretenduan, ndër të tjera, se votat e hedhura për partitë e tyre iu dhanë qëllimisht partive të tjera. Ato pretenduan gjithashtu se disa prej votave të hedhura për PD-në, u numëruan në favor të partive të ALDM-së, veçanërisht PR-së dhe se disa vota të hedhura për PS-në u numëruan në favor të partive të koalicionit të mëparshëm qeverisës, në veçanti PSD-së.

KZZ-të e zonave 2, 64 dhe 73 nuk pranuan të numëronin votat e një numri të vogël kutish votimi. KQZ-ja shkarkoi, gjobiti, dhe filloi ndjekje penale ndaj anëtarëve të KZZ-së së zonës zgjedhore nr. 2 dhe gjobiti KZZ-në e zonës zgjedhore nr. 64 për moszbatim të ligjit dhe udhëzimeve të KQZ-së. Në zonën 2, votat e dy kutive mbetën të panumëruara deri në emërimin e një KZZ-je të re që, gjithashtu, nuk e përfundoi numërimin e votave. KZZ-të nr. 64 dhe 73 dërguan kutitë e pahapura në KQZ.⁵⁴

Disa KZZ, ku vëzhguesit vërejtën parregullsi gjatë numërimit të votave apo përpilimit të tabelave të rezultateve, duke përfshirë zonën 36 (Tiranë) dhe 43 (Kamëz), kërkuan tabela të reja të paplotësuara që përdoren për të përpiluar tabelën e rezultateve nga KZZ-ja. KZZ-të pretendonin se tabelat origjinale ishin përdorur gabimisht nga grupet e numërimit ose ishin të palexueshme për shkak të korrigjimeve të gabimeve gjatë plotësimit të tyre. KQZ-ja vendosi t'u jepte KZZ-ve tabela të reja, vetëm në rast se KZZ-të dorëzonin tabelat origjinale në KQZ.

Natën e zgjedhjeve, mbështetur mbi informacionin e KZZ-ve, KQZ-ja filloi nxjerrjen e rezultateve paraprake të pjesshme⁵⁵ për zonat njëmërore dhe listat shumë-mërore të partive në disa zona, duke i shpallur në media dhe duke i publikuar në faqen e internetit të KQZ-së. Megjithatë, disa KZZ nuk dërguan rezultatet e pjesshme në KQZ. Ndërsa KZZ-të përfundonin numërimin e votave dhe përpilimin e tabelave të rezultateve, KQZ-ja zëvendësonte të dhënat fillestare me rezultatin e përmblledhur për zonën. Kjo mënyrë veprimi, megjithëse lehtësonte barrën e punës, reduktoi transparencën e procesit duke penguar një krahasim të rezultateve të pjesshme me rezultatet e përmblledhura në nivel zone. Gjithashtu, do të ishte e parapëlqyeshme që KQZ-ja të vendoste të publikonte në faqen e saj të internetit të gjitha rezultatet në nivel QV-je.

Një përmblledhje e rezultateve zyrtare paraqitet në Shtojcën I.

XV. ANKIMET DHE APELIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE

Subjektet zgjedhore (partitë, koalicionet, apo kandidatët) mund të paraqesin ankime kundër vendimeve të KZZ-së mbi rezultatet e zgjedhjeve në nivel zone brenda dy ditëve nga marrja e vendimit. KQZ-ja i shqyrton këto ankime brenda 10 ditëve. Vendimet e KQZ-së mbi këto ankime mund të apelojnë në Kolegjin Zgjedhor brenda pesë ditëve.

Gjithashtu, brenda 10 ditëve nga dita e zgjedhjeve, subjektet zgjedhore mund t'i kërkojnë KQZ-së shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve për një qendër votimi, një zonë zgjedhore, ose

⁵² Në zonat 12, 18, 36, 37, 43, 61, 64, 89 dhe 92 vëzhguesit treguan se ose votat e hedhura për lista të veçanta shumë-mërore u zëvendësuan me qëllim në grupimet e votave për parti të tjera dhe u numëruan në favor të partisë tjetër, ose, gjatë përpilimit të tabelave të rezultateve, votat duket se "u rishpërndanë" midis partive.

⁵³ Këto pretendime u ngritën në zonat 7, 17, 55, 58, 67, 68, 72, 77, 78, dhe 93.

⁵⁴ Për një analizë të hollësishme të rastit të zonës 73, ju lutem të lexoni Shtojcën II.

⁵⁵ Rezultatet përfshinin rezultate të përmblledhura të disa QV-ve që ishin numëruar deri në atë çast.

për mbarë vendin.⁵⁶ Afati i shqyrtimit të këtyre kërkesave nga KQZ-ja është 10 ditë. Ajo mund të shpallë pavlefshmërinë e zgjedhjeve, nëse kanë ndodhur shkelje të ligjit, për pasojë të një fatkeqësie natyrore, ose kur votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se gjashtë orë dhe procesi zgjedhor është cënuar në një masë të tillë që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në njësinë zgjedhore ose në shkallë vendi.⁵⁷

Vendimet e KQZ-së për ankimet kundër rezultateve zgjedhore apo për kërkesat për pavlefshmëri kërkojnë votën e të paktën pesë anëtarëve të KQZ-së. Nëse një kërkesë ankimore apo kërkesë për pavlefshmëri nuk siguron këtë shumicë, ajo konsiderohet e rrëzuar.

Nëse pavlefshmëria e zgjedhjeve për mandatin njëemëror në QV nuk prek rezultatin e zonës zgjedhore, KQZ-ja mund të vendosë të mos urdhërojë përsëritjen e zgjedhjeve në këto QV. Sidoqoftë, nëse dhënia e mandatit do të cënohej nga shpallja e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në QV të veçanta, KQZ-ja është e detyruar të urdhërojë përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore. Teorikisht, kjo kërkesë mund të çojë në përsëritje të shpeshta të zgjedhjeve në një zonë, vonesa në shpalljen e rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, rrjedhimisht, në mbledhjen e Kuvendit të ri dhe krijimin e qeverisë së re. Ndonëse KQZ-ja ka kompetencë për të shpallur pjesërisht të pavlefshëm votimin për listat shumëmerore, zgjedhjet e shpallura pjesërisht të pavlefshme nuk përsëriten.

KQZ-ja mori 281 kërkesa ankimore kundër rezultateve të vendosura nga KZZ-të⁵⁸ dhe 107 kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve. Pothuajse të gjitha këto kërkesa u rrëzuan. Pranë Kolegjit Zgjedhor u depozituan 99 apelime kundër vendimeve të KQZ-së⁵⁹. Përveç dy apelimeve të pranuar, të tjerat u rrëzuan.⁶⁰ Ndonëse vetëm pak apelime u pranuan, pjesa më e madhe e tyre u trajtuan në mënyrë korrekte.

KQZ-ja nuk mori në shqyrtim 96 ankime kundër rezultateve zgjedhore për arsye procedure. Shumica e 185 ankimeve të tjera u shqyrtua nga KQZ-ja përpara kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve, kryesisht pasi këto kërkesa për zona të caktuara u paraqitën pas shqyrtimit nga KQZ-ja të ankimit fillestar. Pjesa më e madhe e ankimeve dhe kërkesave për pavlefshmëri të zgjedhjeve ishin të pabazuara dhe pasqyronin refuzim për të pranuar humbjen zgjedhore. Shpesh, partitë ose kandidatët nuk ishin në gjendje të siguronin prova thelbësore për të mbështetur pretendimet e tyre ose nuk kërkuan marrjen në konsideratë të provave që mund të kishin lidhje me çështjen.⁶¹ Rastet e pakta të bazuara humbën nën peshën e morisë së pretendimeve të pabazuara. Për rrjedhojë, KQZ-ja u përball me një sfidë të vërtetë për të shqyrtuar pretendime brenda kuadrit kohor të parashikuar nga ligji.

⁵⁶ Kur për të njëjtën zonë paraqiten njëkohësisht kërkesa ankimore dhe ajo për pavlefshmëri, atëherë KQZ-ja shqyrton më parë kërkesën për pavlefshmëri. Kërkesa ankimore shqyrtohet vetëm nëse kërkesa për pavlefshmëri është rrëzuar.

⁵⁷ Neni 117 i Kodit Zgjedhor (varianti shqip) lejon KQZ-në të shpallë pavlefshmërinë e zgjedhjeve edhe nëse nuk ka ndikim të mundshëm mbi shpërndarjen e mandateve. Megjithatë, në një rast të tillë zgjedhjet nuk përsëriten.

⁵⁸ Nga 281 kërkesa ankimore, 54 u depozituan nga PD-ja (ose kandidatët e saj) dhe partitë e koalicionit ALDM, 92 u depozituan nga PS-ja dhe parti të tjera të koalicionit të mëparshëm qeverisës, 21 u paraqitën nga LSI-ja dhe pjesa tjetër prej 114 ankimesh u depozituan nga subjekte të tjera zgjedhore.

⁵⁹ Shtatë ankime u paraqitën në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimit të KQZ-së për rezultatet përfundimtare.

⁶⁰ Apeli që u pranua kishte të bënte me refuzimin e KQZ-së për të shpallur të pavlefshme zgjedhjet në zonën 90. Kolegji Zgjedhor urdhëroi që rezultatet e zgjedhjeve për të dy votimet të shpalleshin të pavlefshme dhe zgjedhjet për mandatin njëemëror të përsëriteshin.

⁶¹ Shumë ankime kundër rezultateve zgjedhore në një zonë kishin të bënin me shkelje të pretenduara më tepër gjatë votimit sesa gjatë numërimit.

Edhe pse shumë ankime ishin të qarta, u duk se disa prej vendimeve të KQZ-së u morën me nxitim. Në ato pak ankime të bazuara, kërkesat rigoroze të Kodit të Procedurës Civile për prova dhe rëndësia që iu kushtua dokumentimit të shkeljeve në Procesverbalin e KZZ-së, nuk lejuan që ankimuesve t'u jepej një zgjidhje ligjore efektive. Parë në këtë vështrim, vendimet mbi këto raste nuk përmbushën angazhimet e OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare. Kjo ishte veçantërisht e dukshme në rastet ku kishte mosmarrëveshje brenda partive.⁶² Në këto raste, u paraqitën prova të besueshme në lidhje me shkeljet gjatë numërimit të votave apo përpilimit të tabelave të rezultateve për listat shumemërore të partive në zona të caktuara. Megjithatë, ato nuk u morën në shqyrtim për arsye procedure dhe KQZ-ja e Kolegji Zgjedhor ishin formalë në qëndrimin e tyre. KQZ-së i mungoi vullneti të përdorte plotësisht të gjitha kompetencat e saj hetimore, për shembull, të kërqyrte të gjitha provat e paraqitura ose të rinumëronte votat.⁶³ Disa parti pretenduan se rivlerësimi dhe rinumërimi i votave do të vërtetonte pretendimet e tyre se, në disa zona, votat për listat shumemërore nuk ishin numëruar me ndershmëri.

KQZ-ja nuk shqyrtoi 7 nga 107 kërkesat për shpallje të pavlefshme të zgjedhjeve, për shak se nuk kishin formatin e duhur ligjor.⁶⁴ Rastet më të shumta ishin kërkesa për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në zona të veçanta, zakonisht në votimin për zonën njëemërore. KQZ-ja shqyrtoi kërkesat për pavlefshmëri gjatë periudhës 14-26 korrik. Ashtu si edhe ankimet kundër rezultateve të zgjedhjeve, shumë kërkesa për pavlefshmëri ishin qartësisht të pabazuara. Shumë parti apo kandidatë thjesht shfrytëzuan dispozitat që lejonin depozitimin e një kërkesë për pavlefshmëri si një "mundësi e dytë" në procesin e ankimimit, pasi KQZ-ja e u kishte rrëzuar ankimin. Në përgjithësi, KQZ-ja i shqyrtoi drejt kërkesat për pavlefshmëri dhe nuk tregoi njëanshmëri pro ose kundër ndonjë pale të interesuar. Gjatë seancave dëgjimore, KQZ-ja thirri në Tiranë më shumë se gjysmën e të gjitha KZZ-ve për t'u konsultuar me to. Shumica e kërkesave u rrëzuan me një shumicë të qendrueshme të anëtarëve të KQZ-së.⁶⁵ Ashtu si për ankimet, KQZ-ja vendosi kundër shqyrtimit të fletëve të votimit apo listave të zgjedhësve të kërkuara nga disa ankimues.

Në ato pak raste kur KQZ-ja pranoi kërkesat për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në zonat njëemërore, votimi në 19 QV në zonën 2 dhe në gjithë zonën zgjedhore 64 u shpall i pavlefshëm.⁶⁶ Kolegji Zgjedhor la në fuqi ankimin dhe shpalli të pavlefshëm votimin në zonën 90. Në të tri zonat u urdhërua përsëritja e zgjedhjeve. Në lidhje me zgjedhjet për listat

⁶² Neni 15 i Kodit Zgjedhor u jep të drejtën partive të paraqesin marrëveshje të brendshme për shpërndarjen e pjesës përkatëse të partisë nga 40 mandatet plotësuese. Në disa raste, kandidatë të së njëjtës parti konkurronin mes njeri-tjetrit për të siguruar mandatin.

⁶³ Nenet 156-158 të Kodit Zgjedhor i japin KQZ-së kompetencën për hapjen e kutive të votimit, rinumërimin e votave dhe sigurimin e provave të tjera, me qëllim marrjen e një vendimi mbi ankimin dhe sigurimin e një numërimi të ndershëm të votave.

⁶⁴ Nga 100 kërkesat e mbetura, 43 ishin depozituar nga koalicioni Partitë Sociale Shqiptare+Partia e Unitetit Kombëtar (PSSH+PUK), 36 nga PS-ja, 10 nga PD-ja, tri nga LSI-ja, dy nga PBDNJ-ja dhe përkatësisht nga një nga PDR-ja, AD-ja, Partia Demokristiane, Partia e Punës, Partia Komuniste dhe një kandidat i pavarur në zonën 100.

⁶⁵ Në dy raste, KQZ-ja votoi 4 me 3 pro pavlefshmërisë së rezultatit të zgjedhjeve (seancat dëgjimore për zonat 15 dhe 37), ku anëtarët e KQZ-së votuan sipas linjave që favorizonin krahun e tyre politik dhe në një rast (zona 90) ku 4 anëtarë votuan për pavlefshmërinë e zgjedhjeve për mandatin njëemëror, megjithëse ishin më pak se shumica e cilësuar që kërkohej.

⁶⁶ Në zonën 2, numri i zgjedhësve në QV-të që nuk ishin hapur më 3 korrik ose që nuk ishin përfshirë në tabelat e rezultateve ishte i mjaftueshëm për të ndikuar në dhënien e mandatit. Në zonën 64, numri i votave që nuk ishin numëruar ishte më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kryesonin.

shumemërore të partive, shumë apelues nuk ishin në gjendje të parashtronin prova për manipulim të zgjedhjeve në atë shkallë që do të ndikonte në shpërndarjen e mandateve. Megjithatë, me raste, apeluesit provuan parregullsi domethënëse gjatë votimit, numërimit, apo përpilimit të tabelave. KQZ-ja vendosi njëzëri shpalljen e pavlefshme të votimit për listat shumemërore në zonën 92, në 19 QV në zonën 2 dhe 2 QV në zonën 8. Sidoqoftë, zgjedhjet nuk u përsëritën pasi Kodi nuk lejon përsëritjen e pjesshme të votimit për listat shumemërore.

Sipas Kodit Zgjedhor, KQV-të duhet të kthejnë në vendet e numërimit të votave tri "kuti votimi": një që përmban fletët e votimit për garën për mandatin njëemëror, një që përmban fletët për garën për listat shumemërore dhe një që përmban "materiale zgjedhore", si për shembull, listat e zgjedhësve, fletë votimi të papërdorura, vula, etj. Nëse deklarohet "e parregullt" nga KZZ-ja, sipas nenit 109/2, kutitë e votimit që përmbajnë fletët e votimit as hapen dhe as numërohen por dërgohen në KQZ për shqyrtim. Për një KQV konkrete, nëse vetëm kutia e votimit që përmban "materiale zgjedhore" konsiderohet e pavlefshme, atëherë numërimi i votave që ndodhen në dy kutitë e tjera të votimit mund të vazhdojë, pasi KZZ-ja vendos në lidhje me rregullsinë e saj.⁶⁷

Një rast veçanërisht polemik, gara për mandatin njëemëror në zonën 73, përshkruhet me hollësi në Shtojcën II. Ky rast tregoi, *ndër të tjera*, se kërkesa për të siguruar 5 vota nga 7 mund të rezultojë problematike kur përdoret nga KQZ-ja për të rrëzuar vendime të KZZ-së mbi rezultate që janë thjesht përlllogaritje matematikore. Më tej, në një rast si ai i zonës 73, kur diferenca midis dy kandidatëve ishte tejet e vogël dhe kur vulat mungonin në disa prej kutive të kthyera, është e debatueshme nëse pavlefshmëria dhe përsëritja e zgjedhjeve do t'i jepte situatës një përgjigje të duhur.

XVI. ZGJEDHJET E PËRSËRITURA, 21 GUSHT 2005

Gara për mandatin njëemëror në zonat 2, 64 dhe 90 u përsërit më 21 gusht 2005. Përfundimi i këtyre zgjedhjeve pati një rëndësi përtej vlerës së tyre. Mospërfundimi i zgjedhjeve në këto zona, e bënte të pamundur shpërndarjen nga KQZ-ja të 40 mandateve plotësuese, pasi nuk mund të zbatonte procedurën e shpërndarjes së mandateve pa plotësimin e 100 mandateve njëemërore. Për rrjedhojë, Kuvendi nuk mund të mblidhej dhe të votëbesonte qeverinë e re.

Pas zgjedhjeve të 3 korrikut, PBDNJ-ja vendosi të bashkohej me koalicionin e shumicës së pritshme parlamentare, i kryesuar nga PD-ja. Kështu, për përsëritjen e zgjedhjeve, PD-ja dhe aleatët e saj kishin një shumicë në të gjitha KZZ-të, KQV-të dhe GN-të. PS-ja kërkoi që KQZ-ja të zëvendësonte komisionerët e propozuar nga PBDNJ-ja me komisionerë nga një parti tjetër. Kërkesa u rrëzua pasi përbërja e komisioneve zgjedhore mbështetet mbi "shumicën" parlamentare dhe "opozitën" parlamentare të Legjislaturës së fundit. Me përjashtim të kandidatëve të PS-së dhe PD-së, partitë e tjera deklaruan se nuk do të merrnin pjesë në zgjedhjet e përsëritura. Megjithatë, për shkak se kandidatët nuk mund të tërhiqeshin zyrtarisht, emrat e të gjithë atyre që morën pjesë në zgjedhjet e 3 korrikut mbetën në fletën e votimit.

⁶⁷ Neni 109/3.6: "[...] Në rast se KZZ-ja ose KZQV-ja konfirmon pasaktësinë ose parregullsinë, e pasqyron atë në Procesverbalin e Konstatimit. Vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në Procesverbalin e Konstatimit, KZZ-ja ose KZQV-ja merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave nga Grupi i Numërimit.

Para përsëritjes së zgjedhjeve, PS-ja kishte paralajmëruar se nuk do të propozonte disa anëtarë të KQV-ve për arsye të pretendimeve për kërcënime, shqetësime në lidhje me sigurinë dhe trysninë ndaj KQZ-së. Në zonën 64, kandidati i PS-së kërcënoi se do të bllokonte procesin zgjedhor, nëse vendndodhja e tri QV-ve nuk ndryshonte. Anëtarët e tri KQV-ve të propozuara nga PS-ja nuk morën materialin zgjedhor. Gjithësesi, në ditën e zgjedhjeve, me përjashtim të tri QV-ve në komunën e Lazaratit, zona 90, dhe pak QV-ve në zonën 2, anëtarët e KQV-ve të propozuar nga PS-ja morën pjesë në KQV. Sidoqoftë, në të tria zonat, partitë i vonuan propozimet e anëtarëve deri në çastin më të fundit të mundshëm. Në zonën 2, kjo ndërlikoi dorëzimin e materialeve zgjedhore të 40 QV-ve të vendosura në komunat malore. Për shkak të emërimeve të vonuara të anëtarëve, trajnimi i KQV-së ishte sipërfaqësor.

Në përgjithësi, përsëritja e zgjedhjeve në tri zona shënoi një përmirësim, krahasuar me zgjedhjet më 3 korrik. KQZ-ja dhe inspektorët e saj meritojnë shumë vlerësime për këtë. Gjithashtu, policia luajti një rol pozitiv dhe përmbushi përgjegjësitë zgjedhore në mënyrë shembullore. Në zonën 2, pothuajse të 70 QV-të u hapën, ndonëse disa prej tyre me disa orë vonesë.⁶⁸ Megjithatë, në të tria zonat, procedurat e votimit sërish nuk u respektuan gjithmonë. Probleme të veçanta përfshinin votimin në emër të të tjerëve dhe atë familjar, mospërdorimin apo moskontrollimin e bojës në gishtin e zgjedhësit, moskontrollimin me imtësi të dokumenteve të identitetit të zgjedhësve dhe disa heqje të pashpjeguara të emrave të zgjedhësve nga listat e zgjedhësve. Dy incidente të dhunshme njollosën zgjedhjet në zonën 90, ku disa persona, përfshirë dy gazetarë, u sulmuan fizikisht.

Numërimi i votave ishte relativisht i shpejtë dhe pa polemika. Nuk u vërejtën probleme domethënëse. Në zonën 2, numërimi filloi vonë, kryesisht për vështirësi logjistike. Të tria KZZ-të i shpallën rezultatet përpara orës 24:00 të datës 22 gusht. Kandidatët e PD-së i fituan të tria zonat me një diferencë të konsiderueshme. Asnjë parti apo kandidat nuk depozitoi kërkesë ankimore apo kërkesë për pavlefshmëri të zgjedhjeve.

XVII. REKOMANDIME

Rekomandimet e mëposhtme parashtrohen për t'u marrë në konsideratë nga autoritetet shqiptare, në mbështetje të mëtejshme të përpjekjeve të tyre për të zhvilluar zgjedhje në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

PARTITË POLITIKE

1. Partitë politike duhet të shfaqin vullnet politik për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike në një masë të njëjtë me privilegjet e gjera që u janë dhënë atyre nga ligji, përsa i përket zhvillimit të zgjedhjeve.

⁶⁸ Megjithatë, dy QV nuk u hapën fare. Vonesa në hapje u vërejtën në QV të tjera ku KQV-të nuk u paraqitën për të marrë materialin zgjedhor. Në dy qendra votimi, kutitë e votimit u dëmtuan dhe dy QV u shpallën të pavlefshme, pasi kryetari i KQV-së, i propozuar nga PS-ja, u largua nga QV-ja dhe mori vulën e KQV-së, duke shkaktuar, për pasojë, pavlefshmërinë e të gjitha fletëve të votimit. Incidente të tjera u raportuan në disa QV të tjera.

2. Për të siguruar që partitë të mund të konkurrojnë me njëra-tjetrën mbi baza të barabarta, siç kërkohet nga paragrafi 7.6 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së, të gjitha dispozitat që bëjnë dallime mes partive politike duhet të hiqen nga Kodi Zgjedhor.
3. Mungesa e njëtrajtshmërisë midis neneve 144 dhe 145/1 të Kodit Zgjedhor duhet zgjidhur për të siguruar njëtrajtshmëri të mëtejshme në dispozitat për financimin e fushatës. Gjithashtu, raportet për financimin e partive duhet të bëhen publike.
4. Partitë dhe kandidatët duhet të tregojnë më shumë respekt për shtetasit, që këta të fundit të shprehin të drejtat e tyre themelore civile dhe politike. Në këtë drejtim, partitë duhet jenë më të përgjegjshme për veprimet e kandidatëve të tyre gjatë fushatës.
5. Shkeljet e fushatës, të tilla si shpërdorimi i burimeve administrative për qëllime fushate dhe blerja e votes, nuk duhen toleruar. Duhet marrë në konsideratë edhe masat për monitorimin e këtyre shkeljeve dhe vënien e shkelësve përpara përgjegjësisë. OJF-të shqiptare mund të luajnë një rol në këtë drejtim.

SISTEMI ZGJEDHOR

6. Nëse ruhet sistemi zgjedhor i tanishëm:
 - Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për të siguruar që objektivi i proporcionalitetit në raport sa më të afërt, sipas nenit 64.2 të Kushtetutës, të mund të arrihet në mënyrë më të efektshme
 - Mandatet plotësuese duhen shpërndarë në përputhje me renditjen e kandidatit, siç është përcaktuar në listën shumemërore para datës së zgjedhjeve
 - Kodi Zgjedhor duhet ndryshuar me qëllim shmangien e një situatë ku shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve në një numër të vogël qendrash votimi të një zonë të vetme zgjedhore mund të çojë në përsëritje pa fund dhe në një vonesë të panevojshme për mbledhjen e Kuvendit të ri.
7. Megjithatë, autoritetet shqiptare mund të dëshirojnë të rishikojnë sistemin aktual zgjedhor në mënyrë përfshirëse dhe gjerësisht konsensuale.

ADMINISTRATA ZGJEDHORE

8. Nëse ruhet sistemi aktual për propozimin dhe emërimin e administratës zgjedhore, Kodi Zgjedhor duhet ndryshuar me qëllim që:
 - Të sigurojë se propozimi dhe emërimi i KQZ-së është plotësisht në përputhje me Kushtetutën;
 - Të parashikojë një administratë zgjedhore më pluraliste dhe më përfshirëse, me fjalë të tjera, një administratë që nuk kontrollohet dhe as mbizotërohet nga dy partitë kryesore; dhe
 - Të parandalojë partitë propozuese që të largojnë në mënyrë arbitrare të propozuarit e tyre. Partitë duhet të gëzojnë të drejtën e zëvendësimit të anëtarëve të komisionit

vetëm në rrethana të veçanta të renditura në mënyrë shterruese. Kjo do të rriste qendrueshmërinë, pavarësinë, paanshmërinë dhe profesionalizmin e administratës zgjedhore.

9. Nëse partitë do të ruajnë të drejtën për të propozuar zyrtarë zgjedhorë, ato duhet të tregojnë një shkallë përgjegjësie në një masë të njëjtë me privilegjet e konsiderueshme që gëzojnë, sipas rregullimeve të tanishme. Më e pakta, ato parti që kanë të drejtën për të propozuar komisionerë zgjedhorë në KZZ, GN dhe KQV duhet t'u përmbahen afateve ligjore për paraqitjen e propozimeve. Në rast të kundërt, duhet të zbatohen pavonesë dispozitat aktuale që u japin të drejtë partive të tjera për të paraqitur propozime.
10. Roli dhe kompetencat e Zyrave Zgjedhore Rajonale duhet të përkufizohen në Kodin Zgjedhor.

REGJISTRIMI I PARTIVE DHE KANDIDATËVE

11. Rregullimi i përcaktuar në nenin 16 të Kodit Zgjedhor, që lejon partitë të regjistrohen pranë KQZ-së me marrëveshje koalicioni me "listë shumemërore të përbërë", duhet të hiqet. Partia duhet të paraqitet në fletë votimi ose si parti, ose si anëtare e një koalicioni, por jo në të dyja format.
12. Mundësia që "anëtarë" të një partie të paraqiten si kandidatë të një partie tjetër duhet të ndalohet, pasi zbeh dallimin midis partive të veçanta, dëmton objektivin e sistemit zgjedhor dhe çorienton zgjedhësit.
13. KQZ-së duhet t'i kërkohet me ligj të miratojë një vendim mbi kriteret dhe metodën për rishikimin e firmave mbështetëse të kërkesave për regjistrimin e kandidatëve, kohë përpara periudhës së shqyrtimit. Me qëllim që KZZ-të dhe KQZ-ja ta përmbushin këtë detyrë me efektivitet, duhet më shumë kohë në dispozicion për shyrimin e firmave.
14. Sanksione ligjore duhen zbatuar në rastet kur firmat mbështetëse duket qartë se janë të falsifikuara. KQZ-së duhet t'i kërkohet të njoftojë partitë kur merret një vendim mbi kërkesat e tyre për regjistrim. Të gjitha partive duhet t'u jepet kohë për të ndrequr gabime teknike në dokumentacionin mbështetës.
15. Kodi Zgjedhor duhet të përkufizojë termin "parti parlamentare". Kjo mund të pengojë deputetët e një partie që të nënshkruajë një deklaratë se është "anëtar" i një partie tjetër joparlamentare, duke bërë të mundur shmangien e asaj partie nga kërkesa për të paraqitur 7 000 firma mbështetëse.
16. Kodi Zgjedhor duhet t'u japë subjekteve zgjedhore të drejtën për të monitoruar të gjithë procesin e shtypjes së fletëve të votimit duke ruajtur, në të njëjtën kohë, sigurinë e procesit.

REGJISTRIMI DHE IDENTIFIKIMI I ZGJEDHËSVE

17. Me qëllim përmirësimin e saktësisë së listave të zgjedhësve, nevojitet urgjentisht një përpjekje e vazhdueshme për përditësimin dhe përmirësimin e saktësisë së regjistrave të gjendjes civile. Përparësi i duhet dhënë ngritjes së një sistemi adresash për ndërtesat dhe pasuritë e tjera të paluajtshme. Përparësi të tjera përfshijnë ndreqjen e emrave të shkruar me gabime, të dhëna të paplota, të dhënat që përmbajnë kodin "999" dhe të dhëna të mundshme të shumëfishta brenda dhe mes kufijve administrativë të njësive të qeverisjes vendore.
18. Për këtë qëllim, zyrat e gjendjes civile kanë nevojë për burime të mjaftueshme financiare, teknike dhe njerëzore. Puna për përditësimin e regjistrave të gjendjes civile dhe, për pasojë, të listave të zgjedhësve kërkon një angazhim afatgjatë, nëse autoritetet shqiptare dëshirojnë që, për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2009, të kenë një sistem tërësisht funksional për regjistrimin e shtetasve (dhe, për pasojë, për regjistrimin e zgjedhësve).
19. Duhet marrë seriozisht në konsideratë krijimi i një forme identifikimi të zgjedhësve, që nuk le shteg për abuzim. Nëse qeveria dëshiron të nxjerrë dokumente të reja identiteti, kjo duhet të paraprihet nga një proces i gjerë konsultimesh. Për sa kohë që "certifikatat e lindjes" janë një formë e lejueshme e identifikimit të zgjedhësit, autoritetet qendrore duhet të sigurojnë se zyrat e gjendjes civile mbajnë të dhëna të sakta zyrtare për certifikatat e lëshuara për të gjitha qëllimet, në veçanti për qëllime zgjedhore dhe se këto të dhëna janë të disponueshme për publikun.
20. Kodi Zgjedhor duhet të qartësojë nëse listat e zgjedhësve mund të përditësohen për zgjedhjet e përsëritura.

MEDIA

21. Minutazhi me pagesë duhet t'u jepet të gjitha partive politike mbi baza jodiskriminuese, pavarësisht nga forca e mëparshme zgjedhore.
22. Duhet ndërmarrë hapa, me qëllim përmirësimin e bazës metodike dhe procedurave të bordeve zyrtare të monitorimit të medias, që veprojnë në shkallë vendi dhe në nivel vendor gjatë periudhave të fushatës dhe monitoruesit vendorë duhet të emërohen në kohë.
23. Partitë dhe media duhet të repektojnë periudhën e heshtjes zgjedhore, menjëherë para ditës së zgjedhjeve.

VOTIMI DHE NUMËRIMI

24. KQV-ve duhet t'u kërkohej të përmbushin dispozitat në lidhje me përdorimin e bojës për shenjimin e gishtit të zgjedhësit. Mund të merret në konsideratë përdorimi i bojës së dukshme që nuk hiqet.
25. Afati i vonë për emërimin e grupeve të numërimit duhet të rishqyrtohet.

26. Vëmendje duhet t'i jepet mënyrës se si procesi i numërimit të votave mund të përfundojë në kohë. Mjete të mundshme përfshijnë rritjen e numrit të anëtarëve të GN-ve përtej maksimumit aktual prej pesë anëtarësh, të paktën në zona me numër të lartë QV-sh, ose lejimin e GN-ve të punojnë me turne. Një zgjidhje praktike mund të jetë krijimi i një numri më të madh të GN-ve, me më pak anëtarë secili.
27. Ka vend për rritjen e transparencës së procesit të numërimit. Të gjithë pjesëmarrësit në garën zgjedhore duhet të lejohen të vëzhgojnë numërimin në mënyrë të barabartë. Përpjekje thelbësore duhen bërë me qëllim përmirësimin e mundësisë së vëzhguesve për të kontrolluar saktësinë e numërimit.

ANKIMET DHE APELIMET

Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për të siguruar që:

28. Zgjidhja ligjore të jetë e përshtatshme për rrethanat, pavarësisht nga fakti nëse kandidati, partia, apo përfaqësuesi ligjor kërkon në mënyrë të veçantë një formë të caktuar zgjidhjeje ligjore.
29. Të ekzistojë një zgjidhje e efektshme në lidhje me shkeljet e ligjit dhe për verifikimin e faktit nëse votat janë numëruar me ndershmëri. KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor nuk duhet të kufizohen pa arsye për llojin e fakteve që mund të marrin në konsideratë gjatë seancave ankimore.
30. Përmbajtjes së ankesës t'i kushtohet më shumë rëndësi sesa formës. Mosregjistrimi i një ngjarjeje në një dokument zyrtar të zgjedhjeve apo në Procesverbalin e KZZ-së nuk përcakton përfundimisht se ajo ngjarje nuk ka ndodhur. Për rrjedhojë, mbështetja e tepruar në procesverbalin e KZZ-së duhet shmangur.
31. Çdo ndikim i partive politike në përzgjedhjen e gjyqtarëve për Kolegjin Zgjedhor të eliminohet.
32. Të harmonizohen afatet kohore të ankimeve paszgjedhore, me qëllim që një kërkesë për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve dhe një kërkesë ankimore kundër tabelës së rezultateve nga KZZ-ja të shqyrtohen bashkarisht. Rekomandohet që ky afat kohor të jetë tri ditë pas përfundimit të përpilimit të tabelës së rezultateve nga KZZ-ja.
33. Të ketë më shumë orientim mbi veprimet që KQZ-ja duhet të ndërmarrë në lidhje me kutitë e parregullta të dërguara nga KZZ-ja dhe qartësi më të madhe për rrethanat në të cilat KQZ-ja ka kompetencë të ndërmarrë një numërim "të parë" të votave, pavarësisht nëse kutitë janë gjykuar të parregullta ose jo.
34. KQZ-ja të kryejë rinumërim apo rivlerësim të votave, në rastet kur përcaktohet se kanë ndodhur parregullsi që mund të kenë ndikuar në dhënien e një mandatit. Në të gjitha rastet e tjera, vendimi për të rinumëruar apo rivlerësuar votat duhet të mbetet në kompetencën e KQZ-së.

35. Të ketë orientime për gjykatat e rretheve gjyqësore në lidhje me dokumentet që duhet të paraqesë një shtetas, emri i të cilit nuk gjendet në listat e zgjedhësve, për të vërtetuar të drejtën për të votuar.

VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

36. Transparenca mund të rritet më tej duke lejuar vëzhguesit vendas të regjistrohen më herët se 45 ditë para datës së zgjedhjeve, si dhe duke ulur afatin për paraqitjen e kërkesave për akreditim për vëzhguesit vendas (aktualisht 15 ditë para datës së zgjedhjeve).
37. KZZ-të duhet të udhëzohen se Vendet e Numërimit të Votave duhet të organizohen në mënyrë të tillë që vëzhguesit të mund të ndjekin si duhet numërimin e votave. Për shembull, largësia midis hapësirës së rezervuar për vëzhguesit dhe tryezave të numërimit nuk duhet të jetë aq e madhe saqë të bëjë të pamundur një vëzhgim të mirëfilltë.

PJESËMARRJA E GRAVE

38. Duhet bërë përpjekje serioze për rritjen e numrit të grave të zgjedhura në Kuvend. Në veçanti, partitë politike duhet të rrisin praninë e grave kandidate në listat shumëmemërore të partive si dhe në zonat njëmemërore.
39. Qeveria dhe Kuvendi duhet të kërkojnë mënyra për të rritur pjesëmarrjen e grave në jetën publike. Qeveria duhet të përgatitë një plan veprimi për të përmbushur këtë objektiv dhe të realizojë angazhimet e marra më parë.
40. Për çrrënjosjen e "votimit familjar" është e nevojshme një përpjekje e vërtetë dhe e vazhdueshme. Toleranca e perceptuar për këtë praktikë bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe fshehtësinë së votës.

PJESËMARRJA E PAKICAVE

41. Autoritetet shqiptare duhet të përmirësojnë regjistrimin e zgjedhësve të popullsisë së pakicave, veçanërisht të bashkësive rome dhe egjiptiane.
42. Autoritetet dhe partitë shqiptare duhet të sigurojnë që çështjeve të pakicave t'u kushtohet vëmendja e duhur gjatë fushatës zgjedhore.
43. Praktika e përpjekjeve për të ndikuar në votë nëpërmjet metodave të blerjes së votës në bashkësitë e pambrojtura duhet të trajtohet në të gjitha nivelet, me synim çrrënjosjen e saj.

XVIII. SHTOJCË 1: PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE ZYRTARE

Më 1 shtator, pas skadimit të gjithë afateve ankimore, KQZ-ja deklaroi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve dhe kandidatët të cilët përfituan nga shpërndarja e 40 mandatëve plotësuese.

Tabela e Rezultateve Zyrtare për Zgjedhjet për Kuvendin 2005

Partia	Numri i votave të hedhura për listën shumëemërore të partisë dhe koalicionit	% e votave	Numri i mandateve njëemërore të fituara dhe % e të gjitha mandateve	Mandatet plotësuese të shpërndara	Numri i përgjithshëm i mandateve	% e të gjitha mandateve	Diferenca ⁶⁹ (% e mandateve minus % e votave)
DP	104 796	7,67	56 (40.00)	0	56	40,00	+ 32,33
SP	121 412	8,89	42 (30.00)	0	42	30,00	+ 21,11
ALDM	457 143	33,46	0 (0.00)	18	18	12,86	- 20,60
PSD	174 103	12,74	0 (0.00)	7	7	5,00	- 7,74
LSI	114 798	8,40	1 (0.71)	4	5	3,57	- 4,83
PAA	89 635	6,56	0 (0.00)	4	4	2,86	- 3,70
AD	65 093	4,76	0 (0.00)	3	3	2,14	- 2,62
PDS	57 998	4,25	0 (0.00)	2	2	1,43	- 2,82
PBDNJ	56 403	4,13	0 (0.00)	2	2	1,43	- 2,70
Të tjera s	124 845	9,14	0 (0.00)	0	0	0,00	
Të Pavarur			1 (0.71)	0	1	0.71	
Totali	1 366 226	100%	100 (71,43)	40	140	100	

Si rredhë, më 2 shtator, Presidenti Moisiu thirri seancën e parë të Kuvendit.

⁶⁹

Nuk përfshihet një analizë e ndikimit të strategjive zgjedhore në masën në të cilën është arritur objektivi i proporcionalitetit, duke qenë se OSBE/ODIHR-i nuk ndodhet në pozitën që të parashikojë zgjedhjet e votuesve nën modalitete të ndryshme të koalicioneve.

XIX. SHTOJCË II: PROCESI ANKIMOR NË ZONËN 73

Në zonën 73, KZZ-ja vendosi se kutitë e votimit me "materialet zgjedhore" të dy QV-ve (nr. 3248 dhe 3260) ishin të parregullta. Njëres kuti i mungonin disa materiale dhe tjetrës i mungonin vulat rezervë. Me vendimin nr. 115, KZZ-ja refuzoi të numëronte votat e këtyre dy QV-ve dhe i shpalli "të pavlefshme" kutitë që përmbanin fletët e votimit, megjithëse Kodi Zgjedhor i referohet "pavlefshmërisë" vetëm në nenin 117 si një kompetencë e KQZ-së. Pas numërimit të votave për të gjitha QV-të, përveç dy të kontestuarave, KZZ-ja mori një vendim tjetër, nr. 116, duke shpallur rezultatin për zgjedhjet për kandidatin. Kandidati i PD-së kryesonte me 34 vota.

Kandidati i PS-së e ankmoi Vendimin nr. 115 të KZZ-së në KQZ.⁷⁰ Vlen të përmendet se KQZ-ja mund ta rrëzonte Vendimin nr. 115 të KZZ-së me shumicë prej katër votash nga shtatë. Në rast se kandidati i PS-së do ta ankimonte Vendimin nr. 116 të KZZ-së për shpalljen e rezultateve, për ta rrëzuar atë do të kërkohej shumica e cilësuar prej pesë votash nga shtatë. Të gjitha kutitë u dërguan në KQZ. KQZ-ja vendosi me katër vota pro dhe tri kundër të hapte kutitë dhe të numëronte përmbajtjen, pasi të kishte shqyrtuar materialet zgjedhore. Megjithëse gjatë diskutimit u parashtruan argumente ligjore e teknike, votimi duket se përkoi me ndarjet partiate. Pakica argumentoi se, sipas Kodit Zgjedhor, KQZ-ja nuk kishte kompetencë të numëronte votat dhe se Kodi Zgjedhor neni 158/3 parashikonte vetëm mundësinë për "rinumërim" ose "rivlerësim" të votave që ishin numëruar më parë. Gjithashtu, kjo tregoi se, ndërkohë që Kodi Zgjedhor kërkon shumicë të cilësuar me pesë nga shtatë vota për të rrëzuar shpalljen e rezultateve nga KZZ-ja (Vendimi nr. 116 i KZZ-së), kjo kërkesë nuk gjen zbatim kur një vendim i ndërmjetëm mbi faktin se cilat vota do të numërohen (baza materiale për rezultatet, Vendimi nr. 115 i KZZ-së), rrëzohet me shumicën e vetëm katër prej shtatë votave.

Në një seancë veçanërisht të mbushur me polemika, votat nga dy QV-të në fjalë u numëruan në KQZ. KQZ-ja konstatoi se numri i votave në këto kuti nuk përputhej me numrin e nënshkrimeve të zgjedhësve dhe një kutie i mungonin të gjitha vulat rezervë. KQZ-ja vazhdoi me numërimin e votave që ndryshonte nga rezultati i KZZ-së, duke i dhënë kandidatit të PS-së kryesimin me 35 vota. Gjithësesi, ndonëse një shumicë prej katër nga shtatë anëtarë të KQZ-së votuan për përfshirjen e rezultateve të këtyre dy QV-ve në rezultatin përfundimtar të zonës, shumica e cilësuar e pesë prej shtatë votave, e nevojshme për të rrëzuar shpalljen fillestare të rezultateve nga KZZ-ja (Vendimi nr. 116), nuk u arrit. Për rrjedhojë, rezultatet e shpallura nga KZZ-ja u lanë në fuqi dhe kandidati i PD-së u shpall fitues. Kandidati i PS-së apeloi në Kolegjin Zgjedhor, që në fund spalli fitues kandidatin e PS-së, meqenëse, pasi ishin numëruar të gjitha kutitë e votimit, ai kishte marrë më shumë.

⁷⁰ Pas një jave, kandidati i PS-së depozitoi një kërkesë për pavlefshmëri të zgjedhjeve në të gjithë zonën, që, në fund, e tërhoqi gjatë seancës së shqyrtimit të kërkesës nga KQZ-ja. Sipas nenit 161/1 të Kodit, KQZ-ja vendosi të mos vazhdonte me procedimin. Ky vendim i KQZ-së u apelua nga kandidati i PD-së në Kolegjin Zgjedhor që e rrëzoi apelimin, pasi neni 161/1 i Kodit i jep të drejtën çdo pale për tërheqje të pretendimit, përveçse kur "KQZ-ja çmon se procedimi është në interes të publikut". Shqyrtimi i ankimit fillestar u pezullua për sa kohë zgjatën procedimet për pavlefshmëri.